



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 3 datë 25-01-2023

**PËR MIRATIMIN E PROCES VERBALIT TË MBLEDHJES TË DATES 28.12.2022 TË  
KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË**

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës **28.12.2022**, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

V E N D O S I

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 28.12.2022 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 21 vota

Vota Pro 21

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 26-01-2023

K R Y E T A R

Erjon NEXHIPI





## PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 28.12.2022

Kryesuesi i mbledhjes është Kryetari i Këshillit z. Erjon Nexhipi.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 21

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej këshilltarësh.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: 2

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 10

### **Pika 1 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Meqënëse shumica e këshilltarëve janë present e celim mbledhjen, në lidhje me rendin e ditës ka kemi një ndryshim në renditje pikën 16 e vendosim para pikës 8? Hedhim në votim rendin e ditës me ndryshimet e propozuara? Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar?

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 2 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E PROÇESVERBALEVE TË MBLEDHJES SË DATËS 24-NËNTOR 2022. (me e-mail)

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Ka diçka në lidhje me këtë pikë? Për procesverbalin e mbledhjes së kaluar? U pa i plotë besoj.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 3 e rendit të ditës**

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.20 DATË 10.02.2022 I NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.78 ,DATË 23.05.2022 TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË "MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA".

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut)zjzj.Etleva Tare.

Këshilltare E.Tare:Ditën e djeshme u mblodh komisioni dhe një ndër pikat që ishte për tu shqyrtuar ka qënë ndryshimi në vendimi nr.20 të datës 10.02.2022, vendimi nr.78 data 23.05.2022 të Këshillit Bashkiak “Mbi miratimin e subvencionimit të qirasë për familjet e pastreha”. Komisioni ra dakord për miratimin. Presim nga anëtarët e këshillit ta miratojnë.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT, "SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË."**

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znjIrena Nikaj.**

Këshilltare I.Nikaj : I propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë relacionin për numrin e familjeve që përfitojnë nga programi social i strehimit “ Subvencionimi I interesave të kredisë”. Edhe në mbledhjen e komisionit të djeshëm u diskutua në lidhje me mënyrën dhe trajtimin e të gjithë atyre që plotësojnë kushtet për të përfituar nga subvencionimi i interesave të kredisë. Në relacion janë miratuar 3 familje të cilat përfitojnë nga programi social sipas ligjeve në fuqi. Propozoj Këshillit Bashkiak të miratojë këtë relacion bashkë me emrat që janë përgatitur nga drejtoria. Kryetar e Komisionit të strehimit i ka miratuar bashkë me Kryetarin e Bashkisë, drejtoria e strehimit social dhe menaxhimit të banesave sociale dhe drejtoria e përgjithshme juridike dhe e burimeve njerëzore.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Sa shkon numri këtë vit?

Këshilltare I.Nikaj : 3

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Në total. Sa kuota të lira kishim?

Ekzekutivi M.Balli: Kemi kuota të lira.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 5 e rendit të ditës**

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS FINANCIARE PËR Z.ARDIAN DYLI, TË CILIT I ËSHTË DËMTUAR BANESA NGA RËNIA E ZJARRIT.**

**(Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit)** znj.Edlira Mitre, z.Julian Kodra, z.Ermir Petriti, znj.Majlinda Like, z.Dejvi Hoxhadhe **(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare)** z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe.

Këshilltari E.Mitre: Në datën 21.11.2022 në banesën e z.Ardian Dyli në fshatin Kuç i zi njësi administrative Bulgarec ka rënë zjarr i cili ka shkaktuar dëme të mëdha në orendi shtëpiake dhe dëme nga ana ndërtimore. Materiali që naka ardhur relacioni është bazuar në nenin 41 të ligjit.45 2019 “Për mbrojtjen civile” dhe VKM 329 dt 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhëna të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”. Pasi I është dërguar komisioni i konstatimit është mbështetur, janë bërë preventivat e duhur nga komisioni është mbështetur gjithashtu edhe nga ekspertët e këshillit të qarkut Korçë dhe është vlerësuar ti jepet shuma 420,902 lekë. Tabelat e mëposhtme që ju i keni në material ju i keni më të detajuara, shpërblimin e z.Ardian Dyli, përpunimit të banesës si dhe arredimit me orendi shtëpiake. Ftoj këshilltarët ta miratojnë këtë relacion.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 6 e rendit të ditës**

**PËR MIRATIMIN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2022-2023 NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE.**

**(Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes)** z.Ervin Rota, z.Joan Deli, znj.Edlira Mitre, znj.Danjela Nasto, znj.Majlinda Duni dhe **(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare )** z. Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Tani kjo është material më vete shtesa apo është brenda kësaj.

Sekretare E.Naçi: Brenda kësaj është.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra ka ndryshim material.

Sekretare E.Naçi: Po ka ndryshim material ose plotësim material.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Cili do e marrë fjalën.

Këshilltare I.Nikaj: Diskutimet që janë nga këshilltarja Taretë cilat duhet ti dëgjojmë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Atëherë komisioni i financave në lidhje me materialin e bursave.

Këshilltare D.Nasto: Lidhur me materialin Etleva kishte disa shtesa, disa sqarime që i kërkoi ekzekutivit edhe mund ti sqarojë vetë nëse ata i kanë diskutuar ose kanë gjetur këtë bazën ligjore. Bëhet fjalë për një kategori nxënësish të cilët kishin ngelur jashtë skemës së përfitimit të bursave.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mund ta përsëritim kërkesën edhe për publikun edhe për këshilltarët që nuk e kanë idenë, dhe për mua.

Këshilltare E.Tare: Me vendim të nr 511 datë 27.07.2022 Për disa ndryshime dhe shtesa që janë bërë në vendimin 666 data 10.10.2019 të KM për kuotat financiare të ushqimit në menca dhe konvikte dhe hartimin e kriterëve për përfitimin e bursave, të pagesave për nxënësit të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike që është bërë i ndryshuar. Midis disa pikave në VKM tek pika 2 shkronja c) është për nxënësit e fëmijë të familjeve në nevojë që janë regjistruar në arsimin bazë për pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë. Ditën e djeshme e kam konsultuar me përfaqësuesit e institucionit që në këtë rast kemi drejtorinë mbështetëse të arsimit dhe një pjesë shumë e mirë e këtyre nxënësve, e këtyre familjeve kanë mbetur jashtë futjes së kësaj skeme sepse nga Ministria e Arsimit ka qënë një kuotë prej 300 personash. Numri i tyre përsëri nga ne si komisioner të mbrojtjes nga diskriminimi e kemi patur dhe vitin e kaluar këtëngërç, unë e kam shprehur këtu dhe ka dalë me diskriminim për Këshillin Bashkiak që nuk më vjen tani në mendje, për drejtorinë mbështetëse dhe për arsimin dhe është dhënë udhëzim që ky numër të jetë më i rritur. Sivjet nga 300 është shtuar është bërë 350. Unë flas gjithmonë për fëmijët që janë në shkollën Naim Frashëri. Ka qënë segregimi i shkollës Naim Frashëri dhe për të gjithë ata fëmijë ju është hequr ushqimi sepse ka dalë nga gjykata e Strasburgut. Të gjithë këta fëmijë që nuk po marrin dot ushqimin unë e kam sugjeruar dhe kam thënë që të gjithë këta fëmijë duhet të futen në kjo listë pavarësisht se ata e përmbushin dhe kriterin. Jo më pak se para disa orësh kam folur përsëri me specialistin e kësaj drejtorie dhe më ka thënë që ne kriterin ekonomik që janë me ndihmë ekonomike nuk e marrim për bazë. Ndërkohë që në vendim thuhet të jenë të regjistruar si punëkërkues të papunë dhe me ndihmë ekonomike. Ndihma ekonomike familjeve ju jepet për të mbajtur familjen me të ardhurat që janë nën të ardhurat normale, nuk mund të jepet edhe për të ndjekur fëmijën në shkollë, nuk mund të përjashtohen. Ne si komisionerë e shikojmë që në të dyja rastet të jetë barabartë për të gjitha familjet që janë në nevojë. Diçka tjetër ishte dhe për fëmijët që janë, kryetari e di shumë mirë dhe unë e kam ngritur për fëmijët që jetojnë në zonën e gjeologjikes., dihet që kushtet atje janë shumë të vështira, edhe pse ato famije janë si punëkërkuese të papunë kanë aplikuar për ndihmë ekonomike, nuk kanë përfitues përsëri një pjesë shumë e madhe e tyre nuk janë futur. Numri i fëmijëve ka qënë 395 që kanë aplikuar

për këtë bursë. 263 me shtesën 50 që është bërë nga ministria që ne kemi lobuar me ata, është futur dhe kanë mbetur jashtë saj 132 fëmijë. Të paktën të futen fëmijët e gjeologjikes dhe fëmijët që janë të gjithë në shkollën Naim Frashëri.

Këshilltare I.Nikaj: Unë dua që kjo çështje e cila shtrohet si një problem që mua më duket i rëndë nga ato që po thotë këshilltarja Tare dhe duhet ndoshta në nivelin e institucionit që përfaqëson të ishte zgjidhur në një vend tjetër jashtë Këshillit dhe pastaj të vendoset pjesa që ka përgjegjësi këshilli, sepse të gjitha ato që dëgjova unë nuk i kemi bërë dhe ka dhe çështje të tjera të cilat duhen diskutuar. Duke përfaqësuar një grup interesi nuk mundet që të shtrijmë këtë për ta ndërtuar nga veprimi apo mos veprimi jonë, prandaj ndoshta do të ishte dicka më vetë e diskutuar për këtë gjë edhe me institucionin edhe me bashkinë përpara se të vinte në Këshilli dhe të thuhet që ne duam këtë.

Këshilltare E.Tare: Profesore mua materiali më ka ardhur ditën e shtunë,ja kam kërkuar sekretares.

Këshilltare I.Nikaj: Më fal ju jeni institucion ku nuk do të prisni që t'ju vijë materiali, po për punën që bëni duhet ti paraqisni ato në institucionet të cilat i mbulojnë. Nuk do presim të shtunë dhe pastaj të dorëzohen të hënë.

Këshilltare E.Tare: Gjithmonë e kam konsultuar me drejtorinë mbështetëse që në fazën e parë që janë dorëzuar dokumentat .

Këshilltare I.Nikaj: Nëse ju përfaqësoni një institucion shkoni me dokumentacion aje, nuk shkoni me konsultim.

Këshilltare E.Tare: Po me dokumentacion.

Këshilltare I.Nikaj: Se këtu tani unë thashë Këshilli Bashkiak, kështu bashkia, kështu komisioneri. Nuk janë kaq të lehta gjërat.

Këshilltare E.Tare: Profesore shkresat kanë erdhur.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Meqënëse u hap si çështje po them disa fjalë për të sqaruar edhe këshilltarët, pasi realisht kjo çështje e fëmijëve/nxënësve që ndjekin shkollën Naim Frashëri edhe trajtimet si në rast segregimi është një çështje që më ka shqetësuar edhe besoj që jo vetëm bashkia por edhe institucionet e tjera, edhe organizata joqeveritare, edhe komisioneri i mbrojtjes nga diskriminimi duhet ta ketë pak të qartë pozicionin e tij, pasi nuk është puna tani të bëjmë fushata që të na duket puna individuale në vendin e punës ku jemi dhe pastaj të krijojmë disa problematika të tjera. Në rradhë të parë për komunitetin, në rradhë të dytë për imazhin e qytetit sepse tani po flasim. Unë të dëgjova me shumë kujdes edhe e di çështjen me detaje, mund ta dinë edhe këshilltarët. Tani nga ana juaj u kërkuar që të rriten bursat si një instrument për të nxitur apo mbështetur nxënësit që të frekuentojnë shkollën. E njëjta ide ka qënë edhe për projektin për paketat ushqimore për nxënësit e shkollës Naim Frashëri. Pra ishte një instrument i qeverisë për të mbështetur fëmijët që frekuentonin këtë shkollë, që vijnë kryesisht nga komunitetet rome dhe egjiptiane, pra ata fëmijë që ta frekuentonin shkollën dhe ky instrument i qeverisë u trajtua nga ana juaj, e disa shoqatave edhe nga ana e komisionerëve për diskriminim si një instrument që bënte diskriminim pozitiv të fëmijëve në këtë rast dhe që coi gradualisht në një segregim, duke

bërë që frekuentimi i shkollës të bëhej vetëm nga fëmijët e komuniteteve romë dhe egjiptiane. Tani u hoq ky instrument, pra paketat ushqimore dhe ju po më kërkoni tani që unë të rrit numrin e bursave për nxënësit e shkollës, përsëri për të njëjtin qëllim që ata të frekuentojnë shkollën. Po tani çfarë garancie kemi? Po më thua që të fusim përsëri instrument që të nxisim fëmijët që të frekuentojnë shkollën dhe nesër pasnesër të dalë përsëri një shoqatë dhe të thotë shiko se po shkon në segregim se për shkak të bursave që ju kemi dhënë këtyre fëmijëve atje po shkojnë vetëm fëmijët e komunitetit romë dhe egjiptian dhe po shkojnë drejt procesit të segregimit. Po e them që duhet të jemi të kujdesshëm kur e bëjmë atë punën. Të mos ju vemë duar edhe këmbë disa instrumentave të cilat qoftë, qeveria, ministria apo bashkia më pak në këtë rast se ka qënë instrument i qeverisë dhe bashkisë së nisur nga e mira. Qëllimi ka qënë i mirë të mos ngrihet këtu një furtunë një gotë me ujë dhe të bëhet këtu që po bëhet nami dhe po shkohet në segregim. Thënë këtë unë jam i interesuar personalisht pranë ministrisë së arsimit dhe ministrit të arsimit që kuotat e bursave për bashkinë e Korçës të rriten, dhe kjo rritja me 50 bursa është bërë falë kërkesës time që ti sqarojmë gjërat. Kemi kërkuar të rriten 100 bursa, nga 300 të shkonte 400, na janë miratuar 50, dhe me këto 350 tani do bëjmë maksimumin për të trajtuar në kushte të barabarta sic e kemi kërkuar edhe ju si shoqatë dhe si komisioner dhe jo vetëm fëmijët e shkollës Naim Frashëri, por të gjithë fëmijët që vijnë nga familje në nevojë dhe që plotësojnë kriteret e VKM-së përkatëse pavarësisht në rast se janë në shkollën Naim Frashëri apo në shkollat e tjera dhe kjo ka qënë edhe kërkesa e komisionerit edhe çështja që u ngrit, pra të trajtohen të gjithë njësoj. Numri i bursave u rrit nga 300 në 350, këto 350 bursa kërkesa ime ndaj ndërrmarjes mbështetëse të arsimit kanë qënë që të shpërndahen bazuar mbi kriteret e VKM-së respektive bazuar nga fëmijët nga familjet në nevojë deri ku të arrijë. Edhe kujdes me këtë fjalën diskriminim, diskriminim, segregim segregim, atje ku është si fenomen të dënohet, por e thashë duhet rol i yni, i shoqatave i komisionerit është ti ndihmojmë këto komunitetet, jo të bëjmë të duket puna jonë dhe ndërkohëtë krijojmë probleme. Nuk e kasha planifikuar ta zgjasja kaq këtë çështje por meqënëse e hape besoj i vlen edhe këshillit.

Këshilltari E.Tare: Kryetar unë vetëm diçka dua të them. Unë këtu kam marrë rolin e komisionerit dhe jo të shoqatës e para, kur është bërë politika dhe programi që është bërë për dhënien e ushqimit për nxënësit e shkollës Naim Frashëri është prekur vetëm një shkollë prandaj ka dalë segregim nuk ka shkuar në shkollat e tjera, ndërsa kjo VKM fut të gjitha shkollat dhe është e shpërndarë në të gjithë qytetin dhe mund të themi në të gjithë shqipërinë si VKM që do të miratohet. Është miratuar ndjesë. Përsa i përket për fëmijët që janë të shkollës Naim Frashëri përderisa ata ju kemi hequr bursën, duke ju hequr paketën ushqimore i kemi vënë këtë bursë, prandaj kam ndihmuar në shkollën Naim Frashëri dhe në shkollën Pandeli Cale sepse e di që problematikat janë shumë të mëdha. I kam ndarë në këtë fenomen sepse më është thënë se ata që janë më ndihmë ekonomike ne nuk do i futim të gjithë, është marrë vetëm si punëkërkuar të papunë dhe unë prandaj e ngrita shqetësimin. Duke e ditur në çfarë kushte ata jetojnë edhe si komisioner e kam kërkuar për të gjitha familjet në nevojë jo vetëm romë dhe egjiptiane.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Si këshilltari nuk je si komisioner e para.

Këshilltari E.Tare: Përderisa u prek si institucion komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Ti e përmende disa herë në fillim, megjithatë të lutem që të mos, po flas si këshilltar VKM-ja nuk parashikon dot në filan shkollë dhe në filan lagje. VKM-ja ka standarte. Në këto standarte respektohen standartet kryetar të VKM-së?



Këshilltare E.Tare: Nuk janë respektuar.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Ku nuk janë respektuar konkretisht?

Këshilltare E.Tare: Në përcjellja e listave që janë bërë nuk janë futur ato familje që kanë qënë me ndihmë ekonomike.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi:Kujdes vetëm një pjesë, nuk dua të përmendet më filan shkollë.

Këshilltare E.Tare: Jo pra nuk është më filan shkollë, dhe në shkollat e tjera nuk I kemi të përcaktuara. Ndihma ekonomike nuk është futur.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Po qe se ka fenomen që është shkelur VKM-ja na i thuaj. Cila pikë e VKM-së është shkelur?

Këshilltare E.Tare: Mund t'ja u japë vetë përgjigjen specialistja.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Po mirë pra se ti po thua që është shkelur.

Këshilltare E.Tare: E pra se ajo më tha që nuk i kemi futur në ndihmë ekonomike.

Specialistja e NSHMAC S.Zguri: Kemi parasysh kriterin ekonomik, në të gjitha shkollat është bërë një barazim duke patur parasysh edhe shkesat e ministrisë nuk është shkelur asgjë.

Këshilltare E.Tare: Kur kemi biseduar pak më parë më ke thënë bëni çfarë të doni sepse nuk e kemi marrë kriterin ekonomik.

Specialistja NSHMAC S.Zguri: Jemi kufizuar me 350. Janë marrë në mënyrë të barabartë, janë marrë në mënyrë të barabartë , janë analizuar kartat e dorëzuara, po të duash të vish ti shikosh.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Domethënë edhe njëherë brenda kuotës 350 që na u miratua nga ministria, pyetja apo shqetësimi duhet të jetë kanë marrë fëmijët që vijnë nga familjet më në nevojë me rradhë deri ku arrijnë 350 apo mund të kenë ndodhur fenomene që të ketë marrë një fëmijë nga një familje më pak në nevojë, ka ndodhur ky fenomeni?

Këshilltare E.Tare: Po.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Po mirë ju mund ta verifikoni se ne listat nuk i kemi.

Këshilltare E.Tare: Listat i kam dhe unë e kam verifikuar dhe prandaj kam qënë shumë e shqetësuar.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Tani të shqetësuar jemi të gjithë, po cilat raste konkretisht.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Pra edhe njëherë se varet si e shtron problemin. E sollët problemin këtu që është institucion, e sollët me shqetësimin e diskriminimit. Nuk e sollët me shqetësimin që kemi një listë që po propozojmë dhe kjo listë ka përfshirë persona jo kaq .në nevojë sa ata që janë jashtë kësaj liste. Po qe se e shtrojmë kështu këtë diskutim, hajde e vazhdojmë mbledhjen , gjeni këto emrat cilat janë dhe mbliidhemi prapë kur ka afat kjo punë. Tani dhe njëherë të jemi korrekt

me atë që sjellim për të diskutuar. Diskutimi siç e solle ishte tërësisht i gabuar për mendimin tim. Nuk dua të gjykoj asnjë, ishte tërësisht i gabuar, e para e sjellë nga aspekti i pozicionit të punës dhe e dyta duke përcaktuar një komunitet të ngushtë sic janë fëmijët që ndjekin një shkollë. Është i gabuar për mua. Po qe se flasim për standarte pastaj, janë respektuar nuk janë respektuar unë nuk di të them se nuk jam i fushës, por ju si komision duhet ti kishit ndarë.

Këshilltare I.Nikaj: Për ta sqaruar, ditën e djeshme ka dale ky shqetësim dhe unë i jam drejtuar këshilltares Tare që ta sjellë me dokumentacion të gjitha vërejtjet që ka, jo më thanë ju thashë. Nuk është niveli serioz të flasim pretendimet të cilat nuk pohohen në mënyrë administrative me document administrative. Edhe sot nuk shikoj të ketë ardhur një dokumentacion që të administrohet dhe ne të kemi parasysh çfarë ka ndodhur, ku ka ndodhur dhe ku janë zhvilluar e para , e dyta pavarësisht nga grupet e interesit që në përfaqësojmë këtu flasim për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të konventës për të drejtat e fëmijëve dhe përpara këtyre ligjeve që janë aderuar nga shteti shqiptar, nga legjislacioni dhe institucionet këtu do të flasim mbi bazën e respektimit të tyre. Secili ndoshta përfaqëson një grup interesi dhe ka të drejtë po kjo bëhet jashtë nivelit ku ne po diskutojmë. Në Këshillin Bashkiak ne diskutojmë për të gjithë ata që përfaqësojnë dhe ne këtu përfaqësojmë të gjitha komunitetet dhe të gjitha grupet shoqërore dhe natyrisht nuk është mirë të flasim për terma të tilla të cilat në shoqërinë shqiptare ka vite që nuk funksionojnë, prandaj dhe unë jam drejtuar dhe vazhdoj të pres nga këshilltarja Tare që të vijë me dokumenta administrative. Më dërgoi një VKM e cila pa u shoqëruar me analizën dhe reflektimin ku janë shkëlur apo ku nuk janë respektuar nuk thotë asgjë.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Pra dhe njëherë përfaqësuesi ekzekutiv, cili standart është bërë për të seleksionuar njerëz. Okay kërkesat mund të jenë 700 ne kemi 350. 350+50. Cili është kriteri i përdorur për tu skualifikuar ose për ti renditur dhe pastaj deri në 350 shkohet, 351 nuk e merr dot.

Këshilltare I.Nikaj: Dokumentacioni i ka z.kryetar.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Po mirë pra është respektuar?

Këshilltare I.Nikaj: Këshilltarja Tare duhet të thoshte kush qenë. Dokumentacioni këtu është përcaktuar .

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Edhe njëherë për publikun le ta thotë ekzekutivi dhe pastaj po ka ndonjë vërejtje tjetër qëky emër nuk duhet përfshirë se nuk i takon, jo këtu në publik le të kalojnë ta sqarojnë veçant.

Specialistja e NSHMAC S.Zguri: Sipas vendimit 366 Këshilli i Ministrave datë 08.10.2019 dhe vendimi 511 datë 27.07.2022 nga KM pika 2.1 kriteri ekonomik shkronja a),b),c) është marrë kriteri 2.2 I rezultateve të arritura, kriteri 2.3 është kriteri jo ekonomik kemi gërmen a),b),c), d) dh) dhe g) dhe pikën 2.4 që është kriteri i degë parësore për zhvillimin ekonomik të vendbanimit të përhershëm, gërma a), në bazë të këtyre në arsimit parauniversitar janë pranuar 350 bursa, është shkollat 9-vjecare dhe gjimnazet, kemi në shkollat e mesme teknologjike profesionale janë pranuar 503, gjithashtu kemi dhe numrin e nxënësve që përfitojnë veshmbathje, pika 17 sipas këtij relacioni janë nxënësit të cilët kanë përfituar statusin ligjor të jetimit, nxënësit të institutit të fëmijëve që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë përfitojnë çdo vit falas veshmbathje libra dhe fletore

dhe vlerësohen me 8000 lekë, gjithashtu pika 20 në këtë relacion nxënësit e pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane të cilat ndjekin shkollat e mesme profesionale përfitojnë falas veshmbathjet, dhe këta marrin një bursë 8000 lekë. Gjithashtu bursa që ju jepet nxënësve tek arsimit parauniversitar, dmth 9-vjecarja dhe gjimnazi ka një kuotë prej 332.007 kjo është sipas vendimit 511 pasqyra 2, kurse kuota ushqimore që u jepet nxënësve konviktore është 222.003 kjo sipas pasqyrës 3 vendimi 511 datë 27.07.2022 dhe këto kuota janë përcaktuar sipas frekuentimit të shkollës pika 16 në relacion. Kemi vlerësuar dhe dy shkresa të njësisë së arsimit, shkresën 6478/54 me protokoll dhe shkresën 6478/64 përsëri me protokoll dhe kërkojmë miratimin e këtyre bursave.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Eva tani që të thuash janë shkelur është përgjegjësi sepse nuk mund të flasim të gjithë sipas qejfit. Nga këshilltarët e tjerë?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

#### **Pika 7 e rendit të ditës.**

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2023**

**(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare)** z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe dhe **(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)** z.Gjergji Kristo, z.Erjon Fecanji, z.Shkëlqim Kajmaku, z.Ermir Petriti.

Këshilltare M.Dojçe: Në bazë të relacionit është paraqitur nga ekzekutivi niveli i pagave të punonjësve, është cekur e gjithë struktura e pagave . Tabela është në mënyrë të detajuar dhe i kërkojmë anëtarëve të këshillit bashkiak që të miratojnë këtë material sipas tabelës bashkangjitur.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Komisioni i rregullores ka për të shtuar diçka? Shoh disa paga kështu 26000, 29000, si është ideja e këtyre.

Ekezkutivi A.Dishnica: Ato llogariten në bazë të shtesës dhe pagës bazëjanë përtej pagës minimale , dmth 26000 është shtesa

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Të gjitha kështu janë këto? Se shikoj një 30000. Ka ndryshim nga pagat aktuale?

Ekezkutivi A.Dishnica: Jo nuk ka, rritja e fundit u bë në shtator.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Po ishte e pjesshme, jo për të gjithë ajo rritja mesa mbaj mend unë.

Ekezkutivi A.Dishnica: Nuk ka rritje tjetër përveç asaj që është bërë, 7%.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

### **Pika 8 e rendit të ditës sipas ndryshimit.**

SIPAS KËRKESË TË SHOQËRISË "QËNDRA SPORTIVE KORÇË".SH.A. PËR THIRRJEN E ASMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË:

- PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË SHOQËRISË "QËNDRA SPORTIVE KORÇË".SH.A.

**(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare)** z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Pra kalojmë si asamble e Qendra Sportive Korçë. Meqënëse ka karakter ekonomik financiar në komision u diskutua?

Këshilltare M.Dojçe : Po e diskutuam dhe në komision, ishin edhe përfaqësuesit e qendrës sportive. Diskutuaam për sa i takon sa ishin të ardhurat dhe shpenzimet e shoqërisë, një pyetje që kishim në nëse janë bërë përpjekje që të ardhurat të rriten vit pas viti dhe po ashtu kishte ndodhur, të ardhurat kanë patur rritje gjatë gjithë viteve në vazhdimësi janë shtuar edhe shërbimet që ofron qendra sportive, një pjesë e tyre janë përdorur për investime po kryesisht të ardhurat e shoqërisë kapnin shifrën 84,433,572 lekë dhe shpenzimet vjetore gjithashtu në po këtë nivel. Shpenzimet vjetore janë llogaritur në bazën e nevojave të mirëmbajtjes së aseteve të shoqërisë, pagat e punonjësve të administratës sigurimet shoqërore, detyrimet mbi tatime për taksat dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve sportive të ekipit të parë të skënderbeut si dhe shpenzime për aktivitete të tjera. Tabelat në vazhdim tregonin në mënyrë të detajuar të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat sipas zërave të ndryshëm të buxhetit. Këto ishin edhe pyetjet që ju drejtuam në atyre nëse ka patur në vizionin e qendrës sportive që të ketë përmirësim të shërbimeve që do të sjellin edhe të ardhura të tjera më të larta për shoqërinë dukei shërbyer edhe më mirë komunitetit. Megjithatë nëse kanë përfaqësuesit diçka tjetër për të sqaruar.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Ka ndonjë pyetje? Në raport me 2022 saështë ndryshimi? Parashikimi gjithmonë, si ka qënë parashikimi vjet me parashikimin këtë vit?

Ekzekutivi V.Ziko: Pothuajse në të njëjtin nivel.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi:Ndonjë pyetje nga këshilltarët? Unë një sugjerim jo në lidhje me buxhetin po në përgjithësi me aktivitetin duke qënë se atje përfshihen në qendra sportive dhe palë të treta është mirë që të qartësohen qytetarët për ato qëi takojnë qëndrës, aktivitete të qëndrës, pagesa të qëndrës, kontribute që mund të japin në qëndër apo dhe pagesa që bën qendra ndaj palëve të tjera dhe aktiviteteve private që kanë trajnerët apo qoftë dhe subjekte të tjera që janë të kontraktuara nga qendra. Është mirë që vazhdimisht të sqarohen njerëzit se ndodh keqkuptim, ai paguan atje për trajnerin është një marrëdhënie e tyre private me trajnerin, s'ka lidhje me qëndrë, mirëpo në opinion qarkullon ndryshe dhe ju takon juve që ta sqaroni vazhdimisht këtëduke vendosur mbase edhe mënyra komunimikimi të përhershme. Them se shërben për të sensibilizuar, tjetër janë aktivitete e bëra nga bashkia në kjo qëndër dhe tjetër janëaktivitetet që bëhen brenda qëndrës nga trajner apo dhe palë të treta që e marrin me qira qëndrën. Ky ishte sqarimi që duhet gjithmonë. Ndonjëpyetje , sugjerim?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 9 e rendit të ditës**

**MBI MIRATIMIN E PROJEKT BUXHETIT VJETOR TË VITIT 2023 DHE PBA 2023-2025 TË BASHKISË KORÇË.**

**(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare)** z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe

Kryetari i këshillit E.Nexhipi:Këto ka llogjikë të jenë bashkë Bona?

Ekzekutivi V.Ziko: Po.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Dokumenti që do të shqyrtojmë tani është padyshim një prej dokumenteve më të rëndësishëm të bashkisë së bashku me paketën fiskale që miratuam në mbledhjen e kaluar janë dy dokumentat që orjentojnë pjesën e projekteve apo punëve që bashkia realizon nëpërmjet mbledhjes së të ardhurave dhe mënyrës pastaj se si i përdor këto të ardhura qoftë nga burimet e veta apo qoftë të ardhura që vijnë nga buxheti qëndror, nga qeveria qëndrore apo nga donatorë të ndryshëm. Përsa i takon pjesës së të ardhurave, projekt buxheti i vitit 2023 kap një vlerë2,077,480 mijë lekë dhe struktura e buxhetit është 56% e këtij buxheti do të mbliidhen nga të ardhurate veta nga taksat dhe tarifat vendore të bashkisë, 26% nga transferta e pakushtëzuar, 17% nga transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe 1% janë nga të ardhurat e

institucioneve të varësisë. Përsa i takon pjesës së transfertave të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara sektoriale ka një rritje prej 81,000,000 lekë ose 15% krahasuar me buxhetin e vitit 2022 gjë që demonstron angazhimin e qeverisë qendrore për të vazhduar mbështetjen ndaj pushtetit vendor ndaj bashkive. Përsa i takon pjesës së shpenzimeve struktura e buxhetit është pothuaj e ngjashme me strukturën e buxhetit të vitit 2022 me një projektim të lehtë kemi një ulje 2% në pjesën e shpenzimeve operative dhe një rritje me 3% në pjesën e investimeve. Këto për strukturën e buxhetit qoftë në pjesën e të ardhurave qoftë në pjesën e shpenzimeve. Në mënyrë më të detajuar do ti shpjegojë drejtorja e financës. Tani përsa i takon atyre drejtimeve apo projekteve apo programeve që bashkia synon të realizojë nëpërmjet këtij buxheti do të ndalem në pikat kryesore pasi materiali që ju keni marrë është shumë i detajuar. Grupi i parë i projekteve i takon investimeve në infrastrukturën rrugore, jemi koshient që pavarësisht investimeve të bëra në vitet e fundit kemi shumë punë për të bërë sidomos në pjesën ruarale të bashkisë pra në fshatrat dhe në zonat infomale të qytetit të Korçës, kështu që në këtë buxhet janë parashikuar 132,000,000 lekë të reja në investime në infrastrukturën rrugore, 60,000,000 lekë të reja janë në buxhetin e bashkisë si institucion i bashkisë, ndërkohë që 72,000,000 lekë të reja janë vendosur në buxhetin e ndërrmarjes të shërbimeve publike. Me këtë buxhet ne synojmë të përmbyllim rikonstruksionin e rrugve në qytetin e Korçës që siç e thashë brenda unazës të qytetit tashmë janë shumë pak fal investimit të madh që po realizohet brenda zonës së fushës së druve. Ne mbyllëm pjesën formale të qytetit me disa boshllëqe të vogla dhe pastaj fokusi jonë kryesor do të jetë me investime në infrastrukturën rrugore brenda qytetit dhe kryesisht pastaj në pjesën rurale pra në fshatrat. Buxhetit i ka paraprirë një seri takimesh në kuadrin e diskutimeve publike në njësitë administrative të bashkisë së Korçës, edhe në qytetin e Korçës. Kemi identifikuar ato që janë kërkesa prioritare të këtyre komuniteteve dhe besoj një pjesë të madhe të tyre do ti adresojmë me buxhetin e këtij viti. Grupi i dytë i projekteve dhe një projekt shumë i rëndësishëm është ai i ndricimit publik, kemi një projekt shumë të madh më vlerën 94,000,000 lekë të reja në bashkëpunim me qeverinë Zvicerani, të ndara 67,000,000 lekë të reja do të jetë donacioni i qeverisë Zviceriane, 13,000,000 lekë të reja është bashkëfinancim i qeverisë dhe 14,000,000 lekë të reja është mbështetja e qeverisë shqiptare duke mbështetur pjesën e TVSH. Me këtë fond do të vazhdojmë projektin e kalimit në ndricim eficient në një pjesë të madhe të rrugëve të qytetit të Korçës. Ndriçimin led në fakt e kemi ofruar para shumë vitesh por tani jemi gradualisht duke i mbyllur rrugët kryesore dhe pastaj do të vazhdojmë me rrugët dytësore, ndërkohë që një pjesë e rëndësishme e këtij buxheti pothuaj gjysma e tij rreth 400,000,000 lekë të vjetra do të shkojnë për investime në ndricimin publik në fshatrat e bashkisë së Korçës dhe ideja është që nëpërmjet këtij buxheti ne të kemi mundësi ta përmbyllim komplet pjesën e ndricimit publik në të gjithë fshatrat e bashkisë së Korçës. Kjo ka qënë një kërkesë që na ka dalë si prioritare në dëgjuesat me komunitetin dhe jam shumë i kënaqur që në muajt e parë të vitit 2023 ne do të kemi mundësi ta realizojmë si projekt. Në buxhet është parashikuar një fond prej 15,000,000 lekë të reja për të vazhduar projektin e termoizolimit të banesave kolektive në bashkëpronësi. Kemi pasur një eksperiencë shumë të mirë gjatë këtij viti ku në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe me agjensinë shqiptare të eficientës së energjisë kemi realizuar këto projekte të termoizolimit në 12 pallate në qytetin e Korçës. Besoj se ka qënë në projekt që ka tërhequr vëmendjen dhe interesin e komunitetit pasi përfitimet nga ky projekt janë të shumfishta duke filluar nga rritja e vlerës së pronës në këto pallate ku është kryer ky investim në uljen e kostove të ngrohjes për shkak të rritjes së eficientës energjitike të këtyre objekteve por edhe në efektin estetik që këto ndërhyrje sjellin në zonat ku zbatohen. Rasti tipik është rruga e dritave të verdha ku pothuaj të gjithë pallatet në këtë rrugë janë trajtuar me këto masa të termoizolimit dhe atje dukesh sikur je

në një realitet tjetër, prandaj dhe ne kemi vendosur një buxhet duke i ftuar edhe banorët që ata të kontribuojnë për të bashkëfinancuar këtë projekt, ndërkohë që përtej buxhetit tonë ne do të vazhdojmë projektin me Fondin Shqiptar të Zhvillimit edhe me partnerë të tjerë për ta shtrirë sa më shpejt këtë skemë me të gjitha zonat e qytetit të Korçës. Kuptohet sfida kryesore e këtij projekti është gjetja e burimeve të financimit kështu që krahas buxhetit të bashkisë, krahas bashkëpunimit me Fondin Shqiptar të Zhvillimit ne kemi ideuar një projekt i cili kombinon energjinë e rinovueshme me eficienten energjitike. Konkretisht jemi duke punuar për ndërtimin e një parku fotovoltai në pronësi të bashkisë së Korçës dhe të ardhurat nga shitja e energjisë që do të gjenerojë ky park do të përdoren pjesërisht nga shlyerja e investimit në realizimin e këtij parku dhe pjesërisht për të hyrë me një fond i cili çdo vit do të përdoret për të bashkëfinancuar projektet e termoizolimit të banesave. Besoj se që megjithë këto instrumenta do të kemi mundësi që këto projekte të zbatohen në një masë më të madhe në vitin 2023 dhe në vitet në vazhdim. Grup tjetër i rëndësishëm i përdorimit të fondeve të buxhetit është arsimiti, krahas buxhetit që ne kemi lënë në pjesën e ndërrmarjes në pjesën mbështetëse të arsimit një pjesë e buxhetit të bashkisë si institucion në masën 65,000,000 lekë të reja do të përdoren për të financuar projekte në rikonstruksionin e shkollave të bashkisë së Korçës. Do të vazhdojmë rikonstruksionin e plotë të shkollës Themistokli Gërmenji duke shtuar në buxhetin e këtij viti edhe sistemin e territorit të jashtëm, duke përfshirë edhe terrenet sportive të jashtme. Kemi planifikuar ndërhyrje në shkollën Naum Veqilharxhi, në gjimnazin numër 3, në shkollën e Vithkuqit dhe në palestrën e shkollës Sevasti Qirjazi. Këto investime janë parashikuar të jenë në formën e bashkëfinancimit me qeverinë Shqiptare me ministrinë e arsimit ashtu sic kemi realizuar edhe projekte të ngjashme në vitet e mëparshme pasi bashkëfinancimi na jep mundësi me skemën aktuale 31% bashkia 70% ministria e arsimit që të ngremë buxhete më të mëdha dhe të kemi mundësi të realizojmë ndërhyrje më të mëdha. Krahas ndërhyrjeve që unë përmenda në buxhetin që kemi planifikuar ndërrmarjes mbështetëse të arsimit është edhe pjesa e mirëmbajtjes periodike që ne kemi për të gjithë objektet e arsimit parauniversitar në bashkinë e Korçës si dhe zëra të tjerë lidhur me mirëmbajtjen e procesit mësimor përsa i takon pjesës të bashkisë së Korçës të institucioneve të arsimit parauniversitar. Grup i rëndësishëm projektesh janë projektet sociale, do ta filloja me pjesën e projekteve që adresojnë problematikat e strehimit, në këtë buxhet kemi planifikuar 15,000,000 lekë të reja për projektin e përmisimit të kushteve të banimit për komunitetet në nevojë, e kemi rritur nga viti aktual, kemi pasur 10,000,000 lekë të reja e kemi bërë , 15,000,000 lekë të reja, kemi gjykuar që janë projekte që japin shumë impakt në komunitet, edhe këtu skema është e bashkëfinancimit ndërmjet bashkisë së Korçës dhe ministrisë së financave dhe me këto 15,000,000 lekë të reja ne parashikojmë që të ngrejmë një buxhet total bashkë me bashkëfinancimin e Ministrisë 60,000,000 lekë të reja dhe sic thashë do të përqëndrohemi në ato ndërhyrje që kanë më tepër impakt dhe në numër përfituesish por edhe në familje që janë realisht në nevojë, edhe në qytetin e Korçës edhe në fshatrat e bashkisë të Korçës. Buxheti do të vazhdojë të mbështetë pjesën e strehimit bonusin e strehimit, kredinë me interes të subvencionuar, për pjesën e strehimit do të vazhdojë mbështetjen për qendrat komunitare, kemi 7 qendra komunitare që i ndajmë në bashkëpunim me këshillin e qarkut dhe fondacionin Emanuel, 4 për familjet në nevojë dhe 3 për të moshuarit, do të vazhdojmë mbështetjen për transportin publik. Jemi e vetmja bashkia që ofron transport publik falas për 15,000 të moshuar pensionist dhe kjo patjetër që ka kosto në buxhet, është 10,000,000 lekë të reja , do të vazhdojë gjithashtu mbështetja për institucione të tjera sociale sic është qendra rezidenciale, ditore, shtëpia e foshnjës apo dhe shërbimet e reja që ne kemi futur për fëmijët AK apo dhe njësisia që kemi ngritur që të mund të ofrojë shërbime pranë familjeve në kuadrin e procesit të deinstitutionalizimit. Përsa i

takon projekteve që lidhen me programin e mbështetjes së sektorit të teknologjisë të informacionit dhe komunikimit një grup shumë i rëndësishëm projektesh pasi lidhet me punësimin e të rinjve dhe të rejave të qytetit dhe të bashkisë, pasi ne i kemi vënë një theks dhe kemi folur shumë 2-3 vitet e fundit dhe do të vazhdojmë të flasim dhe ta mbështesim dhe vitet në vazhdim. Përsa i takon infrastrukturës synojmë të përfundojmë gjatë muajve të parë të vitit që vjen qëndrën inovacionit tek ish godina e këshillit të qarkut për ta bërë atë funksionale për kompanitë e para të biznesit që do të vendosen atje, synojmë ta shtrijmë programin e trajnimeve jo vetëm për moshën mbi 18 vjet por edhe për moshën e fëmijëve mbi 7 vjet, prandaj në këtë buxhet kemi planifikuar një fond për rikonstrukcionin e bibliotekës së fëmijëve me idenë që të kemi në këtë ndërtesë një model të ngjashëm me atë që kemi aplikuar tek biblioteka e re , pra të shërbejë godina jo vetëm si bibliotekë me funksion të leximit klasik të librit por dhe si godinë ku ne do të ofrojmë kurse të ndryshme trajnimi për fëmijët e moshës nga 7-15 vjet. Krahas trajnimeve jashtëshkollore kemi menduar që ja vlen të mbështetim edhe procesin e mësimin të lëndëve të teknologjisë informatikës edhe si pjesë e kurrikulës shkollore, ka disa iniciativa shumë të rëndësishme të qeverisë shqiptare për ta filluar lëndën e informatikës nga klasa e parë këtë vit shkollor duke investuar edhe në disa laboratorë të informatikës, kësaj iniciative të qeverisë meqënëse ne e kemi prioritet si bashki, i bashkëngjitemi edhe ne duke investuar në 5 laboratore në shkolla 9 vjecare dhe të mesme të qytetit të Korçës, ndërkohë që do të mbështetim edhe projektet të trajnimit për 120 fëmijë të moshës nga 10-15 vjet si dhe mbështetjen për Korça ICT Academy që e kemi sjellë vitin e kaluar në Korçë në bashkëpunim me të rinjtë e CODE for ALBANI ku këtë vit synohet të kemi rreth 150 të rinj si përfitues të projektit jo vetëm nga qyteti i Korçës por nga e gjithë Shqipëria. Këto janë vetëm një pjesë e projekteve që ne do të kemi në kuadrin e këtij programi por patjetër me këtë buxhet që kemi lënë këtë vit do të mbështetim edhe organizimin e eventeve të ndryshme apo të trajnimeve për të rinjtë. Aktivitetet që synojmë jo vetëm të rritin ndërgjegjësimin në të rinjtë edhe në familjet e qytetit por rëndësinë që ka edhe për potencialin që e marra me teknologjinë krijon për këta të rinj dhe të reja por edhe pse jo të mbështetim sic thashë një pjesë të ktyre aktiviteteve apo infrastrukturës që lidhet me to. Përsa i takon fshatit projektet tona në fshat janë të ndara në disa drejtime. Infrastrukturën rrugore unë e përmenda, një pjesë e rëndësishme e buxhetit prej 130,000,000 lekësh të reja për infrastrukturën rrugore do të shkojnë në fshatrat e bashkisë së Korçës. Kemi identifikuar disa projekte që na kanë dalë nga dëgjesat me komunitetin ndërkohë që do të jemi të hapur pastaj që edhe në bashkëpunim me fondin shqiptarin e zhvillimit pasi investimet në infrastrukturën rrugore nuk është se do të realizohen vetëm nga fondi që ne parashikojmë në buxhetin tonë me mundësite tona, por patjetër që ne do të bashkëpunojmë me fondin shqiptar të zhvillimit. Tani fokusi jonë do të jetë në fshat , pjesën e ndricimit e përmenda 400,000,000 lekë të vjetra do ta mbyllim komplet pjesën e ndricimit rrugor në të gjithë fshatrat e bashkisë së Korçës. Do të vazhdojmë projektet në mbështetje të sistemeve të ujitjes së kullimit të parcelave që kanë qënë projekte që vlerësohen shumë nga fermerët, e kanë dhënë impaktin e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë për të rritur aksesin në tokat bujqësore dhe për të krijuar kushte më të mira vaditje dhe kullimi duke dhënë impakt dhe në rendimentin e kulturave bujqësore. Do të vazhdojmë me projektin e kanalizimeve në fshatrat e bashkisë Korçë pasi në rastin e investimeve që kemi bërë vitet e fundit në drejtim të ujësjellsave kemi një situatë goxha të përmirësuar. Në pjesën e kanalizimeve nevojat janë shumë të mëdha, parashikojmë 2 ndërhyrje në Turan dhe në Melcan që do të realizojmë në bashkëpunim me fondin shqiptar të zhvillimit, do të jenë ndërhyrje të plota që do të jenë sipas filozofisë që ne do të kemi për ndërhyrje në kanalizime dhe në fshatra të tjerë pra jo vetëm rrjet i dëndshëm, jo vetëm kanalizimet kryesore por edhe impiantet e trajtimit të ujrave të



përdorura që edhe në zonat rurale duhet të arrijmë standartin që kemi në qytetin e Korçës, që jemi qyteti i parë dhe ndër të paktët në Shqipëri që kanë impiante të trajtimit të ujrave të përdorura funksionale duke arritur një standart të rëndësishëm të bashkimit European. Për pjesën e fshatit, risia do të jetë përfshirja e bashkisë edhe në projekte që lidhen drejtpërsëdrejti me përmirësimin apo uljen e kostove të fermerëve në kultivimin e kulturave bujqësore dhe pastaj edhe në aksesin e tyre në treg. Konkretisht kemi 2 projekte , projekt ide që lidhen me mollët e cila është një nga kulturat kryesore bujqësore të bashkisë së Korçës. I pari lidhet me aplikimin e teknikave smart agriculture që ka për qëllim të ulë kostot e fermerëve për rritjen e këtij prodhimi, nëpërmjet uljeve të numrit të spërkatjeve apo të trajtimeve të ndryshme që krijon në këtë produkt bujqësor dhe projekti i dytë lidhet me ndërtimin e një qendër të seleksionimit dhe të paketimit të mollëve qëti shërbejë të gjithë fermerëve që kultivojnë mollë për zonën e bashkisë së Korçës. Vendosja e kësaj qendër do të jetë në zonën e Dvoranit, njësisë Mollaj që është edhe njësi që ka numrin më të madh të fermave që merren me rritjen e mollëve por patjetër kjo qendër do t'ju shërbejë edhe fermerëve që rritin mollë në fshatrat e tjerë të bashkisë Korçë. Është një projekt që po shohim ta aplikojmë në bashkëpunim me ministrinë e bujqësisë duke parë edhe mundësitë e aplikimit me fondet e ipard-it. Përsa i takon artit dhe kulturës, patjetër që arti dhe kultura zenë vend të rëndësishëm në buxhetin e bashkisë. I lem një sasi të konsiderueshme të fondeve, nëse nuk do të kemi halle apo problematika të tjera, pasi siç e kam thënë edhe herë të tjera na takon edhe për shkak të asaj se çfarë Korça përfaqëson në historinë e artit dhe të kulturës shqiptare. Duhet ta mbajmë Korçën në elitën e qyteteve shqiptare përsa i takon aktiviteteve artistike dhe infrastrukturës. Përsa i takon infrastrukturës brënda këtij viti do të përfundojë dhe do të bëhet funksionale godina e artit kulturës dhe inovacionit. Njëpjesë e saj, salla multimediale u bë funksionale pra pati një inagurim para pak ditësh, është një koncept shumë interesant që e bën këtë sallë një inovacion jo vetëm të aktiviteteve artistike dhe kulturore por fut edhe një dimension të ri të përdorimit të saj, që është përdorimi i saj për aktivitete multimedias ku unë shoh një hapësirë pafund të përdorimit të saj për shumë aktivitete qoftë të ekspozitave të ndryshme, promocioneve të ndryshme dhe thënë këto ka mundësi të pafundme për ato të rinj dhe të reja që e kanë me pasion të marrin njohuri në fushën e kulturës, të përpunimit të videos, të grafik design, për të bashkëpunuar atje dhe për të krijuar atje shumë projekte interesante dhe të bukura. Jam i bindur që do të jetë një hapësirë unike në shqipëri dhe shumë shpejt do të shohim aplikime në të dhe evente të formave nga më të ndryshme jo vetëm të artistëve shqiptar por edhe të artistëve të huaj, ndërkohë që buxheti mbështet edhe një kalendar të pasur të aktiviteteve artistike dhe kulturore në të gjitha zhanret e ndryshme. Përsa i takon sportit , edhe pjesa e mbështetjes për sportin është shumë e rëndësishme. Nëpërmjet këtij buxheti ne synojmë të arrijmë disa objektiva, e para është përpunimi masivimi i sportit dhe këtu patjetër do të bashkëngjitemi projektit të rëndësishëm të qeverisë shqiptare për mbështetjen dhe krijimin e klasave sportive me një pjesë të shkollave 9-vjecarë dhe të mesme të bashkisë. Ne do të mbështetim me këtë buxhet edhe krijimin e akademive dhe patjetër dhe të ekipeve profesioniste dhe të sportit amator me qëllim që të kemi të gjithë nivelet duke filluar nga klasa sportive të cilat furnizojnë me element akademitë sportive, ato furnizojnë me element ekipet profesioniste të cilat kanë mundësi pastaj të arrijnë rezultate të mira duke u shndëruar në modele të cilat nxitin frekuentimin në nivelin bazë. Kemi parë këtë zinxhir të funksionojnë në pjesëne futbollit, tani po e shikojmë në pjesën e volejbollit. Jam shumë i bindur që do ta shohim edhe në sportet e tjera , ndërkohë që do të zgjerojmë edhe gamën e shoqatave apo sporteve që do të behen pjesë e klubit shumësportesh. Këtë vit ne kemi futur këtë klub, shoqatë e hipizmit duke përfituar nga fakti edhe i atyre djemvë të apasionuar pas hipizmit, ndërkohë që duam të futim edhe sportin e skive. Për

skitë ne mund të flasim gjatë unë mendoj që korca ka shumë potencial për ta zhvilluar këtë sport dimëror, jo vetëm duke e parë atë si aktivitet sportiv por edhe duke e parë edhe si një aktivitet që gjeneron turizëm. Turizmi dimëror i skive do të jetë një nga gjërat të cilat ne do të merremi më shumë dhe do të fokusohemi gjatë këtij viti, me shpresën që të kemi mundësi të realizojmë në territorin e bashkisë tonë një strukturë dimërore të sportit të skive e cila mungon sot në Shqipëri. Diçka tjetër kemi parashikuar edhe financimin e projektit të ndërhyrjes në rikonstruksionin e pallatit të sportit pasi unë mendoj që duhet ta plotësojmë atë zonën sportive me investim në pallatin e sportit , unë besoj ne momentin që do ta kemi projektin do të kemi mundësi të sigurojmë edhe financimin për ta realizuar këtë konstruksion, edhe investimin në rikonstruksionin e ndërtimit të një stadiumi dhe investimin në pjesën e një pishine të mbyllur. Këto 3 investime do ta plotësojnë kuadrin e zonës sportive të qytetit të Korçës duke krijuar pastaj hapësirat që në këtë zonë të kryhen jo vetëm aktivitete sportive por të jetë edhe në funksion të turizmit sportiv. Përsa i takon turizmit patjetër është një prej prioriteteve të punës së bashkisë. Është një nga sektorët që gjeneron të ardhura, ekonomi, punësim dhe këtë e shohim edhe në këto ditë të festave të fundvitit ku Korça është shndërruar në destinacioni kryesor dhe ku kemi shumë vizitor. Mendoj që potenciali turistik i Korçës si qytet si bashki, i zonës së Korçës si qark është akoma i pa shfrytëzuar. Kemi shumë për të bërë për të tërhequr flukse të turistëve të huaj, me qëllim që ta përmirësojmë raportin turist vendas, turist të huaj. Kemi një projekt shumë tërëndësishëm në bashkëpunim me fondin shqiptar të zhvillimit që mbështetet nga BE dhe banka europiane për rindërtim dhe zhvillim, në kuadrin e të cilit ne do të punojmë për hartimin e një strategjie të turizmit për bashkinë e Korçës që do të ketë brenda saj patjetër edhe pjesën e paketave turistike. Jemi duke punuar shumë për këtë gjë dhe shpresoj që të arrijmë të bëjmë diçka për të rritur fluksin turistik dhe për të rritur gamën e produkteve apo paketave turistike që ne ofrojmë si bashki. Brenda buxhetit kemi edhe një listë me një kalendar eventesh duke filluar nga festa e birrës, festivali i karnavaleve dhe evente të ndryshme që ne i shohim jo thjeshtë si evente që promovojnë tradita apo vlera të caktuara të qytetit tonë por i shohim edhe si evente që i shërbejnë edhe profilit turistik të Korçës, pasi turistët duan të dinë me se të merren. Prandaj ky kalendar eventesh , së bashku me infrastrukturën e përgjithshme të qyteti apo të fshatrave që ne duam ta përmirësojmë i shohim të lidhura edhe në funksion të përforcimit të profilit tonë turistik. Këto janë një pjesë e atyre projekteve apo programeve që unë mendoj duhet ti ndaja me ju në mënyrë të vecantë duke i dhënë një theks të veçantë që besoj kanë një interes të shtuar edhe për komunitetin për ata që na ndjekin live apo për ata që do të na ndjekin nëpërmjet kronikave. Buxheti është më i detajuar ju ftoj pra ta miratoni këtë buxhet për ti çelur punën pastaj fillimit të zbatimit të këtij buxheti , duke filluar nga ditët e para të vitit që vjen.

Ekzekutivi V.Ziko: Do të thoja dy fjalë lidhur me përgatitjen e buxhetit për vitin 2023 dhe PBA 2023-2025. Buxheti është përgatitur duke ju referuar dhe ligjit 68 Për financat evetëqeverisjes vendore, ligji 139 Për vetëqeverisjen vendore, udhëzimi standarti i buxhetit, ligji për buxhetin e vitit 2023 si dhe të gjitha akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të cilat janë në fuqi dhe njëkohësisht shkresës së ministrisë së financave të muajit nëntor mbi hartimin e PBA 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023 për bashkinë Korçë, Gjirokastrë dhe Mirditë. Siç e dini bashkia Korçë ka hyrë në një fazë të re të miratimit dhe hartimit dhe zbatimit të buxhetit të vitit 2023 dhe të PBA 2023-2025 dhe kjo falë mbështetjes së qeverisë Zvicerane sipas projektit për financat lokale SECO dhe mbështetjes së Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë dhe konkretisht dhe drejtorisë së financave vendore. Bashkia Korçë është përfshirë në një proces ku u bë e mundur për vitin 2023 ulja e numrit të programeve dhe kjo është risia e këtij buxheti. Nga 36 programe që ishin në vitin 2018 , u arrit në 20 programe rreth viteve 2021-2022, dhe për vitin 2023 arriti në 9

programe. Në këto 9 programe përfshihen 28 funksione të cilat do të menaxhohen nga bashkia dhe cdo program dhe funksioni i bashkisë shpenzimet i ka shpërndarë sipas produkteve. ~~Programet sipas metodologjisë të re do të shërbejnë si instrument i menaxhimit në bashki për~~ planifikimin ekzekutimin dhe monitorimin e buxhetit në kuadrin e programeve buxhetore. Risia e këtij buxheti është që programet do të jenë me një kod 5-shifror që do të thotë 2 shifrat e para do të jenë sipas rendit alfabetik dhe 3 shifrat e fundit do të jetë kodi i identitetit të qeverisjes, që do të thotë kodi i bashkisë Korçë do të jetë 122, ndërsa produkti do të jetë me një kod 7-shifror pra të gjitha shpenzimet do të mbahen në nivel produkti, produkti do të jetë me një kod 7-shifror i cili do të jetë unik dhe specifik dhe do të jetë unik për të treja bashkitë dhe për këtë po punon ministria e financave e cila maksimumi sot ose nesër do të dërgojë këto kode dmth do të ketë ndryshim me materialin që është paraqitur sepse do të jenë të treja kodet unike. Pra ky projekt me 9 program zbatohet vetëm për 3 bashki Korçë, Gjirokastrë dhe Mirditë. Për vitin 2023 tani po kaloj në shifra dhe shifrat që do të shpreh do të jenë në mijëra lek dhe kuptohet me lekë të reja. Buxheti i Bashkisë do të jetë me vlerën 2,077,480 lekë. Pra duke e krahasuar me vitet paraardhëse në vitin 2022 do të ketë një rritje prej 10%, në vitin 2021 24%, në vitin 2020 26%, dhe në vitin 2019 19%. Në materialin e buxhetit për vitin 2023 është paraqitur sipas burimeve të financimit, sipas llogarive ekonomike, sipas programeve dhe sipas institucioneve. Sipas burimeve të financimit burimet kryesore të financimit të bashkisë janë transferta e pakushtëzuar ose grandit, transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore të cilat për të mos i përmendur i përmendi kryetari kështu që do kalojmë në analizën e buxhetit sipas llogarive ekonomike, ku shpenzimet e personelit për vitin 2023 kanë një rritje 11% dhe zenë 40% në totalin e buxhetit, rritja është si rezultat i zbatimit të vendimit të KM për ndryshim të pagës minimale dhe për rritje të pagave i cili u bë gjatë muajve shtator, mesatarisht 7%, sipas vendimeve 625 dhe 627 të KM. Me shpenzimet korrente zenë 44% të totalit të buxhetit dhe kanë një rritje prej 7%. Vlen të theksoj që në shpenzimet korrente përveç shpenzimeve operative që ka cdo institucion, janë dhe shpenzimet të ndërrmarjes publike të cilat realisht ato janë investime por për shkak të strukturës të shpenzimit ne i kemi futur në shpenzime operative siç janë materialet e ndërtimit, asfaltet betonet etj. Në këtë program janë përfshirë dhe shërbimet e transportit urban, shërbimi i pastrimit, shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave etj. Ndërsa në shpenzimet për investime theksoj këtë vit shpenzimet kanë një peshë specifike rreth 13% dhe janë të rritura në masën 42%. Shpenzimet paraqiten sipas programeve, pra buxheti paraqitet edhe sipas programeve të cilat këtë vit janë 9 programe buxhetore. Programi i parështë Planifikim, Menaxhim dhe Administrim i cili ka dhe peshën specifike të totalit të buxhetit prej 80%. Në material janë paraqitur të gjitha ato funksione të cilat do të përfshihen në ky program ku janë funksioni i planifikimit menaxhimit dhe administrimit, çështjet financiare dhe fiskale, pagesa e borxhit, planifikimi urban dhe vendor, aktivitetet e ndryshme sportive, kontributi për qëndrën sportive Korçë dhe klubet e futbollit. Programi i dytështë siguria publike e cila ze 3% nga totali i buxhetit, në këtë program përfshihen pagesat të cilat do të kryen për policinë bashkiake dhe për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi. Programi i tretështë Mbështetja për zhvillimin ekonomik vendor i cili zë 3% nga totali i buxhetit dhe përfshin të gjitha pagesat që do të kryehen për zhvillimin ekonomik, bujqësinë administrimin e pyjeve dhe zhvillimin e turizmit. Programi i katërt mbrojtja e mjedisit e cila në total nga buxheti zë 9% dhe këtu përfshihen shërbimi i pastrimit, depozitimi i mbetjeve në landfil, si dhe investime me termoizolim e banesave me bashkëfinancim. Në programin e shërbimeve publike vendore të cilat kapin 30% të totalit të buxhetit përfshirë programin e mirëmbajtjes së varrezave publike,

shërbimi i transportit në të gjitha funksionet që menaxhohen nga ndërmarrja e shërbimeve publike.

Zamira: Po vazhdoj me programin kulturë sport dhe argëtim e cila ka një peshë specifike ndaj totalit të buxhetit rreth 6% dhe tek ky program përfshihen të gjitha shpenzimet e planifikuara për klube shumësportesh dhe qëndrës së artit dhe kulturës. Përsa i përket arsimit bazë dhe parashkollor peshë specifike që zë ndaj totalit të buxhetit është 22% dhe tek ky program përfshihen shpenzime operative dhe shpenzimet që menaxhohen nga bashkia për funksionin e arsimit, cerdhe dhe të gjitha shpenzimet që menaxhohen nga ndërmarrja e shërbimeve mbështetëse të arsimit dhe cerdhes. Përsa i përket programit të arsimit të mesëm të përgjithshëm ai zë njëpeshë specifike prej 5% dhe tek ky program përfshihen shpenzimet operative dhe investimet që menaxhohet nga bashkia për këtë funksion, si dhe shpenzimet për arsimin e mesëm dhe konviktet e arsimit parauniversitar që menaxhohen nga ndërmarrja e arsimit mbështetës të arsimit dhe cerdhes. Dhe programi i fundit është programi i kujdesit social i cili zë 3% ndaj totalit të buxhetit dhe këtu përfshihen të gjitha funksionet që menaxhon bashkia në fushën e përkujdesit social, strehimit si dhe shpenzimet e planifikuara për qëndrën ditore, qëndrën rezidenciale dhe shtëpinë e foshnjës. Vlen për tu theksuar që në buxhetin e vitit 2023 është planifikuar fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës të cilat shkojnë në vlerën 20,000,000 lekë. Nëse do të bënim një analizë të shpenzimeve sipas institucioneve peshëspecifike që këto institucione zënë ndaj buxhetit është konkretisht ndërmarrja e shërbimeve publike që ka njëbuxhet prej 538,345 zë 26%, ndërmarrja e shërbimeve mbështetëse të arsimit dhe cerdhes i cili ka një buxhet prej 470,965 lekë zë 23% , përsa i përket klubit shumësportesh ka një buxhet prej 49,137 lekë dhe zë 2%, qëndra e artit dhe kulturës ka një buxhet prej 83,147 lekë dhe zë 4%, dhe bashkia me një buxhet prej 929,476 lekë dhe me një peshë specifike prej 45%. Gjithashtu dua të theksoj që në buxhet janë të detajuara të gjitha projektet që kanë në bëjnë në fushën e turizmit dhe atë të përkujdesit social me të detajuara të cilat menaxhohen nga bashkia dhe nga ndërmarrja e shërbimeve mbështetëse dhe të arsimit. Përsa i përket një informacioni të shkurtër për PBA 2023-2025 në fazën e tretë vlen të theksohet që buxheti për vitet 2024 dhe 2025 do të jetë në të njëjtin nivel me atë që është miratuar në fazën e dytë dhe 2023 ndryshe nga vitet e tjera është pjesë e buxhetit të PBA2023-2025. Pra risia e këtij viti është pra nëse më përpara ne përgatitnim material për buxhetin afatmesëm më vetë dhe për buxhetin vjetor më vete këtë vit ato janë korporuar së bashku dhe ne dalim me një material, pra për buxhetin vjetor dhe PBA 2023-2025.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Nga komisioni ka diçka? U mbledh komisioni?

Këshilltare : Komisioni u mbledh dje, u sqaruan disa detaje që kishin të bënin në lidhje me pjesën e ndryshimit që e përmendi dhe Valbona të 9 programeve dhe të gjithë diskutimet e tjera të cilat i përmendi dhe kryetari , pikat kryesore të cilat lidheshin dhe ajo që ka qënë prioriteti kryesor gjatë gjithë këtyre viteve në lidhje me programet që lidhen me teknologjinë e informacionit, gjithashtu dhe pjesa e projekteve të tjera që lidhen me bujqësinë e zgjuar që u përmend dhe atje, janë projekte që mendojmë të kenë një ecuri shumë pozitive ,të shprehen ashtu sic janë përfaqësuar edhe në pjesën e buxhetit gjithashtu dhe të turizmit se nuk dua ta le pa përmendur dhe atë meqënëse Korça këto vite ka marrë një zhvillim të konsiderueshëm në këtë fushë. Mendojmë që janë gjetur pikat kryesore që është mirë të financohen dhe që të jenë projekte

fitimprurëse dhe ti shërbejnë të gjithë komunitetit. Ftoj të gjithë anëtarët e këshillit bashkiak që ta miratojnë dokumentin t buxhetit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka?

Këshilltare I.Nikaj: Vazhdimisht atje thuhet që përjashtimet nga taksat apo detyrimet është ndikim negativ në lidhje me buxhetin.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Këtë pjesën e dytë nuk e kuptova mirë.

Këshilltare I.Nikaj: Po thuhet vazhdimisht përsëritet që përjashtimet janë ato që e ndikojnë negativisht në disa raste.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Tani përsa i takon lehtësive fiskale që ne miratuar në paketën fiskale ato kanë njëvlerë rreth 31,000,000 lekë të reja impakt në buxhet, pjesën kryesore e ze përjashtimi që bëhet nga taksa e pasurisë për familjet me pensionistë të vetmuar dhe grupi i dytë me vlerë të madhe të konsiderueshme është përjashtimi që ne bëmë nga tarifat vendore për familjet me kryefamiljarë me ndihmë ekonomike. Pra të dyja këto kanë impakt rreth 25,000,000 lekë të reja ndërkohë që masat e tjera fiskale që kemi marrë plotësojnë lehtësime në masën 31,000,000 lekë të reja. Këto i kemi miratuar në paketën fiskale dhe shumë mirë që i kemi mbështetur. Ky është impakti i tyre në vlerë.

Këshilltare I.Nikaj: Atëhere duke qënë se ne i kemi miratuar këto nuk kemi pse ti mëshojmë në efektin negativ sepse ne i kemi bërë në vlerësim të politikave sociale të bashkisë. Ato janë nëzbritje por kanë një qëllim më të madh për t'ju ardhur në ndihmëtë gjithë atyre që ne kemi vendosur ti mbështesim.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Nuk e di konkretisht çfarë është thënë.

Këshilltare I.Nikaj: Përsëritet vazhdimisht , atje ku është bërë një lloj vlerësimi ka dhe një fjali të tillë që është, në disa.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Nuk e di konkretisht kujt i referoheni.

Këshilltare I.Nikaj: Shikojini ku keni bërë ato.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Ndërkohë që për pjesën e debitorëve patjetër që drejtoria e të ardhurave të bashkisë përpiqet vazhdimisht si pjesë të punës së saj krahas arkëtimit të detyrimeve që janë më vonesë edhe në arkëtimin e detyrimeve që janë në taksapagues apo tatimpagues të bashkisë që janë debitorë. Kemi ngritur një sistem dhe besoj se ka funksionuar duke përdorur të gjitha ato instrumenta që parashikon ligji për mbledhjen e këtyre detyrimeve të prapambetura, ndërkohë që kemi pasur mirëkuptimin dhe gadishmërinë që në raste të caktuara kur ka pasur vështirës ekonomike edhe të realizojmë marrëveshjen e subjektit që janë debitorë për ta mbledhur detyrimin me këste. Në dijeninë time jemi nga bashkitë që e kemi më të strukturuar këtë pjesën e detyrimeve, që nga mbajtja e një liste të debitorë dhe deri në përdorimin e të gjithë instrumentave ligjorë për arkëtimin e këtyre detyrimeve edhe në bashkëpunim me institucione të tjera duke filluar nga bankat, nga rregjistri i barrave siguruse tek drejtoria e transportit dhe shumë bashkëpunime me ASHK-në, jemi bashki e strukturuar në këtë pjesë por nuk është se kemi shmangur apo nuk kemi debitor.

Këshilltare I.Nikaj: Ka disa të dhëna atje që janë në shifra relativisht .

Zv kryetar i bashkisë K.Kita: Për të dyja pyetjet tek faqja 15 e buxhetit thuhet, theksojmë këtu se tek taksa mbi ndërtesën se ndikim negativ në këtë planifikim kanë pasur lehtësi fiskale të ndërmara nga bashkia Korçë për vitin 2022 janë përjashtuar 5128 dhe ky efekti është negativ se këto duhet të ishin të ardhura të bashkisë.

Këshilltare I.Nikaj: E kuptoj, duke qënë se ne themi me vetëdije këtë, se negativ do të thotë kur ne nuk kemi ndikuar, ne e bëjmë me vetëdije këtë emër të politikave sociale që ndjek bashkia, kjo mund të thuhet që planifikohet me pakësim

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Njëqëndrueshmëri financiare efekt negativ quhet.

Zv kryetar i bashkisë K.Kita: Në realizimin e të ardhurave të bashkisë, kurse përsa i takon masave shtrënguese ato biznesi i ka të përcaktuara në bazë të ligjit për procedurat tatimore se çfarë masash duhet të marrë pasi kalon afati për pagesën. Pagesat janë të përcaktuara i marrim zakonisht në fillim të vitit, deri në datën 20 prill dhe për taksat për ndërtesën bësoj deri në 30 qershor, kemi vënë 2 afate në paketat fiskale ndërkohë pas këtij afati fillojnë procedurat të përcaktuara në ligjin për procedurat tatimore, fillon bllokimi i llogarive bankare të subjektit, më pas kalojmë tek transporti që bllokohet dhe automjeti dhe më pas tek hipoteka bllokohet pasuria e subjektit, dhe në momentin që subjektet kanë detyrime kanë veprime me këto institucione janë detyruar të vënë të bëjnë pagesat në bashki, të lirohet prona apo nr i llogarisë apo automjeti që disponojnë dhe kjo është në varësi të veprimatrive që kryejnë me bankat apo me institucionet. Ne në fakt kemi një eksperiencë shumë të mirë me të gjitha këto institucione, është vënë në zbatim ky vendim i qeverisë për procedurat tatimore dhe nuk kemi pasur veprime sepse ndodh edhe shpesh që nëpër banka të ketë veprime të subjekteve debitore pavarësisht se ne kemi cuar urdhër bllokimi apo dhe në transporti apo dhe tek hipoteka. Tashmë ajo është bërë zë në këtë pjesë dhe ne paguajmë një tarifë për të gjitha bllokimet dhe në hipotekë dhe në transporti dhe në këtë detyrim që ne paguajmë ja marrim mbrapsht subjekteve dhe nëse një pagesë për një bllokim është 1000 lekë të reja atëherë përveç detyrimit që ka edhe kamat vonesa paguan edhe këtë detyrimin ndaj institucioneve.

Këshilltare I.Nikaj: Sa ditë zgjat nga bllokimi tek shlyerja dhe rihapja e atyre që ju bllokoni?

Zv kryetar i bashkisë K.Kita: Po kjo vazhdon deri në momentin që subjekti vjen likujdon detyrimet, domethënë ne nuk i kryejmë shërbime dhe këto institucione nuk kryejnë shërbime deri në momentin që do të jenë të likujduar. Nëse ai nuk ka veprime, shitje makine.

Këshilltare I.Nikaj: Jo e kam fjalën, për momentin e bllokove makinën, erdhi i pagoi detyrimet, kur i zhbllokohet makina?

Zv kryetar i bashkisë K.Kita: Që në momentin që ai bën pagesën, edhe brenda ditës.

Këshilltare I.Nikaj: Brenda ditës mund të ndodhë edhe për llogari bankare ?

Zv kryetar i bashkisë K.Kita: Po, po.

Këshilltare I.Nikaj: Po në rregull. Të them dy fjalë në lidhje me vlerësimin sipas apo ka pyetje? Në përgjithësi unë e vlerësoj projekt buxhetin dhe parashikimin për buxhetin afatmesëm dhe pavarësisht nga versionet që keni mua më duket që është pozitive prirja që është shfaqur qoftë nga të dhënat në shifra qoftë nga paraqitja që ju i keni bërë si ekzekutiv atyre që konsiderohen veprimtari themelore për të realizuar përgjegjësitë dhe pritshmëritë e qytetarëve dhe komuniteteve. Nga pikëpamja e komisionit që vlerëson çështjet sociale të rinisë, të drejtat e njërit

etj mua më duket me shumë interes pesha e projekteve dhe vazhdimësia e tyre dhe objektivat që janë parashikuar për tu realizuar, të gjitha këto janë me shumë rëndësi, dhe janë sidomos për çështjet e dhunës, viktimat e dhunës ka prioritet vazhdimësia arritja e mbështetjes financiare dhe shtrimi edhe i projekteve të tjera. Pjesa që ndoshta do të ishte me interes do të ishte dhe pjesa e vlerësimit të arritjeve dhe të ndërtimit të një pune që të tregojë çfarë është arritur në vitin e kaluar dhe çfarëndryshimesh do të sjellë nga pikëpamja qoftë vlerash qoftë objektivash . Pra parashikimet janë vërtet pozitive, të dukshme nga pikëpamja e objektivave që kanë dhe ndikimit që ato do të sjellin në fushat përkatëse ku janë ndërtuar. Në kuadër të një propozimi që ne kemi bërë për Gratë e Vitit unë do t'ju sugjeroja që këtë pjesën edhe për shkak se unë mendoj se 8 Marsi nuk është një ditë feste unë mendoj që, për tu bërë një ditë ku bëhen bilance në kuadër të asaj unë do doja ta shikonit mbase ta mbanit shënim në kuadër të asaj Gratë apo Gruaja e Vitit paraardhës 2022, 2023 e kështu me rradhë sepse mendoj që kjo do të jepte më shumë shance për të vlerësuar se çfarë ka ndryshuar nga ajo që ne e kemi lënë më parë. Ne kemi bërë këtë propozim dhe ju e keni pranuar por do të ishte mirë që edhe të ishte në projektbuxhet që ju propozoni dhe unë shpreh votën pro këtij buxheti, projektbuxheti.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarë të tjerë ka dicka? Nga qytetarët? Institucionet e varësisë?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Shoqata Gruaja në zhvillim Korçë në raport mbi monitorimin e çështjes së kontratës sociale .

Përfaqësuese e shoqatës E.Pambuku: Kontrata sociale zbatohet në 12 bashki të vendit në kuadër të dy projekteve që shkrihen tek njëri-tjetri , të financuara nga qendra kombëtare OLOPANK dhe fondit kombëtar për demokoraci. Shoqatat jonë si pjesë e këtij rrjeti ka hartuar këtë kontratë për bashkinë Korçë në korrik të vitit 2021 është firmosur nga të dy palët nga përfaqësuesja Entela Macka kryetare e shoqatës Gruaja në zhvillim dhe kryetari I bashkisë z.Sotiraq Filo, por dua të sqaroj dhe të theksoj që kjo kontratë është një kontratë morale. Me pak fjalë nga fokus grupet me qytetarët kemi evidentuar problematika për zgjidhje por që janë sipas këndvështrimit të tyre prioritare. Këto prioritare janë pjesë edhe kësaj kontratës sociale që juve e keni përpara, kemi organizuar takime me qytetarë, organizues , përfaqësues nga drejtoritë përkatëse të bashkisë, dhe anëtareve të këshillit bashkiak gjej rastin ti falenderoj që kanë qënë pjesë prezente e takimeve tona, tyre zave të rrumbullakta dhe janë përballur me kërkesat dhe prioritetet që kanë parashtruar. Të jemi të ndërgjegjshëm që ka indiferentizëm nga ana e qytetarëve për tu përfshirë në politikbërje, prandaj në qëndër të punës tonë ne kemi qytetarët që ti mbështetim, ti ndërgjegjësojmë që të jenë ata më përfshirës, më aktivë, që zëri I tyre të dëgjohet nga pushteti vendor. Këtu do të përmend mbështetjen e banorëve të fshatit bulgarec në realizimin e një

peticioni drejtuar Këshillit Bashkiak për rikonstrukcionin e shkollës së fshatit, një prej prioriteteve të kontratës sociale dhe përmbushja e kërkesave të tyre nga bashkia e cila e ka rritur ndjeshëm besimin kundrejt institucionin e bashkisë dhe këtu gjej rastin t'ju falenderoj për reagimin pozitiv dhe më besoni që ka pasur një mbështetje positive të këtyre banorëve të fshatit bulgarec, sepse ka pasur një reagim pozitiv. Sot pjesa e shkollës është ndarë nga ajo e kopshtit, ka qënë një nga kërkesat emergjente të banorëve, qytetarëve por edhe drejtueses të kësaj shkolle. Në vazhdim ne kemi monitoruar realizimin e këtyre prioriteve nëpërmjet informacioneve të marra si nga institucioni i bashkisë, nga monitorimi i vendimeve të këshillit bashkiak dhe nga vetë qytetarët. Shkurtimisht po jap informacion se cilat kanë qënë këto prioritete. Prioriteti i parë ka qënë ndërhyrje në investime, përmirësimi i infrastrukturës dhe rrugëve dytësore për bashkinë e Korcës duke ju referuar rrugëve për 4 njësi administrative përgjatë punës tonë ka rezultuar që janë realizuar në masën 88,33 %, ngelet për tu adresuar në vazhdim në rajonin 2 afaltimi i rrugëve "Mihal Ciko", "Naum Karanxha", "Poli Ceko" në lagjen 4, pajisja me trotuareve e rrugëve "Mihal Ciko" dhe "Aleksandro Ilo" tek të cilat janë të papërfunduar për arsye sepse janë në pronësi private, ne i kemi ndjekur nga afër të gjitha, edhe qeveritarët të cilët kanë ardhur natyrisht edhe punën që është bërë nga bashkia. Në fshatin Bulgarec aktualisht është asflatur rreth 80% e rrugëve të brendshme si dhe janë pajisur me trotuar rruga e Krishter, kështu që unë mendoj se 90% e rrugëve të fshatit janë pajisur me ndricim dhe ngelet edhe pak që ky prioritet të realizohet 100%. Në fshatin Mborje ngelet për tu adresuar sistemimi i ujërave në rrugën e Korresë, Ulicës dhe Kasabasë ndërsa në fshatin Mollaj shtrimi i rrugëve dhe parcelave bujqësore. Prioriteti i dytë ka qënë trajtimi i disa prej institucioneve le të themi parauniversitar në lidhje me këtë prioritet ngelen për tu adresuar në njësinë administrative Korçë rikonstrukcionin i dritareve dhe tualeteve tek gjimnazi 3 dhe më vjen mirë tani kur dëgjova që kryetari sapo tha që ka përfshirë në buxhetin e vitit të ardhshëm gjimnazin 3 i cili ka qënë një kërkesat e qytetarëve, ndërkohë që kërkohet ndërhyrje edhe në dy shkolla 9- vjecare Asdreni dhe Ismail Qemali. Ndërkohë që në njësinë administrative Drenovë ndërtimi i një këndi sportiv në shkollën e fshatit Mborje në territorin pas shkollës, ndërsa një njësinë administrative Mollaj duket që ende ngelet problem i pazgjidhur shkolla e mesme e bashkuar, izolimi i lagështisë nga kjo shkollë e cila në gjëndje shumë të rënduar për shkak të lagështisë dhe amortizimit. Tek prioriteti 3 renditja e politikave të punësimit për të rinjtë natyrisht këtu kemi se çfarë të themi se në lidhje me këtë prioritet bashkia dallohet për iniciativa dhe nxitjen e politikave në ndihmë të të rinjve por gjithmonë ka vend për përmirësim. Tek prioriteti 4 është rritja e ndihmës për grupet e kujdesit shoqëror, për këtë prioritet bashkia ka mbështetur iniciativa të ndryshme. Gjej rastin të them që qëndra burimore e cila është hapur pranë shkollës special është natyrisht një ndihmë shumë e madhe për të gjithë fëmijët të cilët tashmë marrin shërbimet e munguara por ajo që është kërkuar nga qytetarët është ndihma që mund t'ju jepet nënave të cilat kanë fëmijë me aftësi ndryshe. Çfarë mund të jenë shërbimet që mund të ofrojnë bashkia për t'ju ardhur në ndihmë këtyre nënave. Prioriteti 5 është trajtimi me prioritet i programeve që nxisin përmirësimin e kushteve të jetesës, strehimit dhe riintegrimin në punë dhe shoqëri të komunitetit rom dhe egjiptian janë përmendur edhe gjatë takimeve dhe mbledhjeve të KB përse i përket strehimit në zonat të ish-geologjikës, konvikti i shkollës bujqësore, ish konvikti i ndërtimit. Bashkia i sugjeron zgjidhje nëpërmjet instrumentit financiar të subvencionimit të qirasës sociale, familjet e strehuara në këto objekte që sigurojnë një kontratë të qiradhënies dhe më pas mbështeten me pagesën e qirasë për strehim në kushtet e një apartamenti në përputhje me të gjitha parimet e strehimit social. Në lidhje me këtë prioritet sugjerohet që tu jepet mundësi fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian të rregjistrohen dhe të frekuentojnë kopshtet pa pagesë pavarësisht statusit të papunë të



prindërve. Prioriteti i fundit bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuara dhe efektiv për buxhetimin me pjesëmarrje për të identifikuar sa më shumë problematika që lidhen me komunitetin. ~~Ne kemi ndjekur nga afër buxhetimin me pjesëmarrje pothuajse në të gjitha~~ takimet kemi qënë prezent , kemi parë që ka pasur prani të qytetarëve por ajo që kemi vënë re ka qënë mungesa e grave dhe vajzave si dhe të rinjve. Mbase bashkia mund të zgjedhë të tjerë që të përfshihen më shumë, pra të rinj dhe vajza që të jenë pjesë e buxhetimit me pjesëmarrje.

#### **Pika 10 e rendit të ditës.**

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.168 DATË 24.11.2022 "PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2023".

**(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare)** z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Ekzekutivi.

Zv kryetari i bashkisë K.Kita: Ne para pak javësh kemi miratuar një tarifë për përdorimin e pistës së patinazhit, e kemi miratuar vetëm për vitin 2022 dhe ne kemi sjell këtë material për ta futur në paketë fiskale relacionin dhe për të futur në paketën fiskale tek tarifat e ndërrmarjve të varësisë dhe konkretisht tek ndërrmarria e shërbimeve publike, tarifën për përdorimin e pistës së patinazhit e cila është e ndarë në dy tarifa, tarifë prej 200 lekë për 30 min për përdorimin e pistës dhe tarifë 100 lekë për 30 min për përdorimin e pisës nga grupe nxënësish të organizuar. Menduam që ta fusim për të vazhduar me mbledhjen e tarifave për muajt janar shkurt derisa ta mbajmë pistën në funksionim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

#### **Pika 11 e rendit të ditës.**

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TAKSI NË BASHKINË KORÇË.

**(Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve)** z.Raqi Themeli, z. Kristi Andrea, znj. Sara Koroveshi, z. Klaus Bacelli dhe**(Komisioni i Zhvillimit Hapësinor dhe Infrastrukturës)** z. Raqi Themeli,z.Kristi Andrea, znj. Sara Koroveshi, z.Klaus Bacelli

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Përpara se të flasë komisioni kisha një pyetje për ekzekutivin. Besoj janë ato kërkesat që i janë drejtuar dhe këshillit, shoqatës se na kanë zënë dhe në rrugë dhe vazhdojnë. Besoj janë konsultuar me këta.

Komisioni përkatës i shërbimeve publike

Këshilltari E.Muharremi : Në kuadër të rritjeve të standarteve dhe shërbimit taksi, vetë sindikata e transportit të qytetarëve me taksi dega Korçë ka bërë disa sugjerime të cilat janë kushte që ata duan t'ju plotësohen për të rritur standartet e shërbimit të cilësisë. Pra ata kanë sugjeruar që për aplikimet e reja për tu pajisur me license taksia apo automjeti të jetë i vitit të prodhimit 2010 dhe në vazhdim, për subjektet të cilat janë të licensuara por duan të rinovojnë licensen e tyre për arsye të mbarimit të afatit të vlefshmërisë të saj subjekti duhet të kryejë rinovim të licensës me autoveturë vit prodhimi 2005 dhe në vazhdim. Kjo vlen edhe bazuar mbi kriteret e emetimit të gazeve duke qënë se automjetet e vitit 2005 e lart kanë një emetim më të vogël të gazeve, por në këto raste të jepet një afat kohor për të kryer zëvendësimin e automjetit si më poshtë: Nëse automjeti është i vitit të prodhimit 1999 e poshtë, subjektit ti jepet një licensë 1 vjecare dhe brenda këtij afati kohor të bëjë dhe rinovimin e automjetit të vetë, ndërsa nëse automjeti është i vitit të prodhimit 2004 i bie ti jepet një licensë 2 vjecare dhe brenda kësaj periudhe ai të plotësojë kushtin e mësipërm. Duke analizuar sugjerimin e sindikatës por duke parë edhe kërkesën dhe numrin në rritje të kërkesave të reja , është parë e udhës që trajtimi të jetë i njëjti si me subjektet ekzistues ashtu dhe me ata të rinj, pra automjeti të jetë jo i vitit 2010 por i vitit 2005 dhe aplikimet e reja për tu pajisur me licensë taksie automjeti të jetë i vitit të prodhimit 2005 e në vazhdim, për subjektet që janë të licensuar por që do të kryejnë rinovimin e licencës gjatë përfundimit të afatit, subjekti duhet të kryejë rinovimin e licencës të autoveturës me vit prodhimi 2005 ose në vazhdim por në këtë rast me një afat kohor për të kryer zëvendësimin e automjetit si më poshtë: nëse automjeti është me vit prodhimi 1999 ose më i vjetër, subjektit t'i jepet një licensë 1-vjeçare dhe brenda kësaj periudhe ai të plotësojë kushtin e mësipërm. Ndërsa nëse automjeti është me vit prodhimi 2000-2004, subjektit t'i jepet një licensë 2-vjeçare dhe brenda kësaj periudhe ai të plotësojë kushtin e mësipërm. Ne si komision u mblodhëm dhe e pamë materialin dhe ftojme këshillin bashkiak ta miratojë.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka dicka?

Këshilltari I.Nikaj: Ne biem dakord që mjetet konsumohen , por nëse mjetet mbahen ashtu si duhet se ne fjala vjen e vlerësojmë atë të automjeteve që mirëmbahen mirë që janë aktivitetet retro etj: Ndoshta nuk është vetëm viti, si mbahet edhe makina dhe çfarë kujdesi ka. Pastaj me 79 taksi ne kemi gjithë ato makina që janë , në parim duhet të jenë ato që përdoren nga.

Ekzekutivi Nikolin : Jo shpjegimi është ky , vlerësimi i automjetit bëhet nga drejtorja e transporteve, vlerësohen edhe parametrat.

Këshilltari I.Nikaj: Ai se merr lejë kështu që nuk ka nevojë për licensë.

Ekzekutivi Nikolin : Ne po pretendojmë, që nuk ka asnjë lloj kufizimi, në lidhje me këtë. Pra mund të vi një automjetë i 91, që mund të jetë në gjendje të mirë dhe ky automjet nuk është i barabartë me një automjet të vitit 2005. Pavarësisht se e kapërzen normën në vlerësimin teknik në qëndrën e kontrollit teknik. Në momentin kur pretendojmë këtë standartin euro 4 që lidhet relativisht me vitin e prodhimit dhe do të jepet licensë në përputhje me këtë vit do të kemi më

pak ndotje atmosferike, ky është thelbi. Një i vitit 90 e ca nuk mund të jetë i barabartë asnjëherë me vitin 2005.

Këshilltari I. Nikaj: Po ju shtroj në parim 79 automjete taksi dhe 6 që janë 8+1 në krahasim me të gjithë flotën e grupin e makinave që qarkullojnë në Korçë të cilat mund të jenë më shumë dhe njëkohësisht kanë edhe problemet e tyre pra nuk mëduket që këto këtu kanë vënd për këtë standartizim që thoni ju që të jenë mbi 2005 , kur vetë zotëruhesit e tyre nuk tregojnë kujdes që edhe nëse nuk është e 2005 ato të kenë pajisje që ju kufizojnë dhe janë sipas parametrave që kërkojnë kushtet teknike të mbajtjes së makinave, se nuk është vetëm viti që tregon kujdesin për makinën. Nëse ajo nuk emeton gaze sipas nivelit që është përcaktuar ajo çfarëdo viti të jetë lejohet qarkullimi.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Për të gjitha përcaktimi sa e lejon? Nuk është se e përbën viti, e përbën më shumë sistemi që ka. Tani këtë ne nuk e zgjedhim në këshillë, po të ishim në Paris ata e certifikojnë, euro 1, euro 2, euro 3, euro 4, ne këtë e zgjidhim me vite se nuk kemi institucion që ta bëjë është i certifikuar euro 5 kjo makina, apo nuk është, ne se bëjmë dot. Nga ky vit në këtë vit makinat kanë dalë euro 4, që nga ky vit në këtë vit ka dalë euro 5, Ne nuk rregullojmë dot tregun ndryshe, ne e rregullojmë nga viti.

Këshilltari I. Nikaj: Ky mua më duket që nuk zgjidh gjë, ky si kufizim, për këtë e ka.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Nga do ta dijë ai që do të bëjë një investim për ta marrë të 2000, ose 2022 por do ta marrë 2012. Nuk e zgjidh kjo, ai mund ta hedh dhe të 2020, ne nuk parashikojmë dot të gjithë këtë cmenduri, që mund të bëjnë njerëz.

Këshilltari I. Nikaj: Nuk është cmenduri, është mosmirmbajtje, pra ky kufizim që thoni ju nuk e përmirëson cilësinë e ajrit që keni problem. Po ti suvencionoj bashkia 5 e nga 5 për cdo vit.

Kryetari i bashkisë S. Filo: Automjetet taksi janë automjete që levizin për çështje biznesi, dhe në të gjithë botën ju vihet një standart më i lartë sesa i lejohet makinave të përdorimit individual. Pra je dakort ti të punosh taksi, të bësh biznes okej do të kesh mjetin sepse supozohet që në dallim nga një individ këtu në Korçë, dhe e nxjerr dhe se nxjerr makinën, ti do lëvizësh tërë ditën për punë. Sot duhet të kesh një lloj standarti më të lartë të mjetit, kjo është idea, dhe pjesa e shoqatës kjo ka qënë, mirë që është liberalizuar tregu fare. Po të mos vinë mjete nga rruga fut një impiant gazi dhe dil leviz bejë punën e një taksie, kjo është e përgjithshmeja. Shumë qytete ja vënë në kusht kalonë makina elektrike, ne nuk po e bëjmë këtë gjë. Një lloj standarti të moderuar, se para ishte për 2010, tani e kemi lënë për 2005.

Këshilltari I. Nikaj: Dhe unë këtu e kisha që nuk ka ndonjë ndikim.

Kryetari i bashkisë S. Filo: Tani përtej humorit, është ideja e këtyre lagjeve 11, 12, 13, nuk janë të mbuluara me transportin publik urban, për shkak të konfiguracionit të rrugëve. Mund të ishte një skemë me mjete elektrike të vogla, ka disa modele që jemi duke i parë. Ja vlen të diskutohet.

Këshilltari i këshillit E. Nexhipi: Është një plan i mirfilltë për menaxhimin e trafikut duke përfshirë dhe këto metoda të transportit publik, duke përfshirë dhe zgjidhjet afatgjata të parkimit atij me pagesë dhe papagesë. I parkimit ekzistues dhe i perspektivës të parkimit sepse jemi dëshmitarë që ky vitë për shkak të rritjes së fluksit të turistëve por edhe të numrit të shtuar të mjeteve që Nikolini mund ti ketë statistika. Vërtetë qyteti i Korçës ka qënë në vështirsi për parkim. Dhe unë jam shumë dakort dhe jam promotor dhe mbështetës i rritjes së nivelit të

turizmit në qytetin e Korçës, por ky turizëm i shtuar nuk duhet të sjellë, një vështirsi të jetës së banorve të Korçës. Duhet të gjendet një lloj ekuilibri midis kësaj, jo sa të na kthehet shqetësim real se në fund të fundit për dikë është biznes e për dikë tjetër ka zgjedhur të jetoj këtu, dhe për derisa kemi zgjedhur të jetojmë këtu nuk duhet të na kthehet ditët e festave ferr, pak ditë mund të jenë por këto ditë që janë unë personalisht përshembull më duket se atë që kanë zbatuar për festën e birrës që largohen nga Korca, i bije ta bëjnë dhe për fundvitin se po kthehet në një situatë e panmenaxhueshme. Duhet parë mundësi forme për tu menaxhuar. Duhet të mendojmë zgjidhje është perpektive e parkimit. S'mundet të bëjë hotel dhe të sjellë vështirësi në gjithë rrugën me makina. Hotelin duhet ta bëjë ai që ka zgjidhjen e parkimit. Nuk e di janë sugjerime mbase dhe arkitektët mund të ofrojnë zgjidhje më inteligjente.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

#### **Pika 12 e rendit të ditës.**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË NR. 111, DATË 03.08.2019, "MBI ZONAT E PARKIMIT ME PAGESË NË RRUGË", I NDRYSHUAR.

**(Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve)** z.Raqi Themeli, z. Kristi Andrea, znj. Sara Koroveshi, z. Klaus Bacelli dhe **(Komisioni i Zhvillimit Hapësinor dhe Infrastrukturës)** z. Raqi Themeli, z.Kristi Andrea, znj. Sara Koroveshi, z.Klaus Bacelli

Ekzekutivi Nikolini: Sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 111, datë 03.08.2019, "Mbi zonat, parkimit me pagesë në rrugë", i ndryshuar, vendparkimet me pagesë në qytetin e Korçës janë:

- A. Vendparkimet në zonën e Teatrit dhe në rrugën "Edit Durham" (51 vende parkimi).
- B. Vendparkimet në rrugën "Kiço Greço" (zona e Pazarit 86 vende parkimi).
- C. Vendparkimet në bulevard "Republika" (zona e Katedrales 82 vende parkimi).
- D. Vendparkimet në bulevard "Fan Noli" dhe në rrugën "Ismail Qemali" (69 vende parkimi).
- E. Vendparkimet pjesë e rrugës "Kiço Greço", në ish-stacioni i autobusëve të linjave ndërqytetëse dhe rrethqytetëse (37 vende parkimi). Dy vendparkimet sipas kësaj kontrate për dy aparatet për karikimin e automjeteve elektrike janë:
  1. Në vendparkimet me pagesë në bulevard "Republika" para bibliotekës të qytetit, pranë ndërprerjes me rrugën "Kryepiskopi Anastas",
  2. Në vendparkimet me pagesë në ish-stacioni i autobusëve në rrugën "Kiço Greço". Gjithashtu subjekti "Raiffeisen Bank" sh.a, i cili ka disponuar tre vende parkimi të rezervuar në bulevard "Republika", për degën e tij në bulevard "Fan Noli" në qytetin e Korçës, ka kërkuar reduktimin e numrit të vendeve të parkimit me qëllim për të mbajtur vetëm një të tillë. Tre vendet që ka disponuar ky subjekt në bulevard "Republika" janë pranë ndërprerjes me rrugën "Sedat Babani".

Propozohet që dy vendet të cilat përdoren prej Raiffeisen Bank të kalojnë në vendparkime me pagesë.

Këshilltari i këshillit E. Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 13 e rendit të ditës.**

PËR MBËSHTETJEN PËR MEMORANDUMIN E BASHKËPUNIMIT ME PROJEKTIN "BASHKI TË FORTA" II DHE AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË BASHKISË Z.SOTIRAQ FILO PËR FIRMOSJEN E KËTIJ MEMORANDUMI.

**(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)**  
z.Gjergji Kristo, z.Erjon Fecanji, z.Shkëlqim Kajmaku, z.Ermir Petriti.

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Atëherë ideja është autorizohet kryetari i bashkisë për firmosjen e këtij memorandumi bashkëpunimi.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Pika 14 e rendit të ditës.**

“PËR DHËNIEN E TË DREJTËS HUAMARRËSIT KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË TË JAPË NË PËRDORIM AMBIENTET E ISH BASHKISË KORÇË, SIPAS PLANVENDOSJEVE BASHKANGJITUR, INSTITUCIONIT TË KUVENDIT TË RSH” .

**(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)**  
z.Gjergji Kristo, z.Erjon Fecanji, z.Shkëlqim Kajmaku, z.Ermir Petriti.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Gjejini një emërtim kësaj ndërtesës se ngelen ish.

Këshilltare A.Verushi: Ambienteve ku ushtron aktivitetin.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Gjejini një emër, emërtojeni.

Këshilltare A.Verushi: Ne e kemi emrin.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Po nuk është ndërtesa vetëm tuaja, është prefektura është dhe ndërmarja. Ti gjendet një emër asaj. Ndërtesa publike e bashkisë Korçë për zyra është fjala.

Këshilltare E.Mitre: Ajo është pjesë që i takon qarkut.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Ti je me huapërdorje, si është.

Këshilltare A.Verushi: Ajo godinë gjysma është qarku dhe gjysma tjetër ne ja kemi dhënë me huapërdorim prefektit.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Nejse po ti gjeni një emër i gjeni, po qe se doni ta mbani kështu mbajeni.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Unë jam me parimin që emri është kapistall.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

#### **Pika 15 e rendit të ditës.**

“PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES ME QIRA, TË TRUALLIT ME SIPËRFAQE 205 M2, PJESË E PASURISË NR.2/353 ZK 8563M, PËR QËLLIME BIZNESI”

**(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)**  
z.Gjergji Kristo, z.Erjon Fecanji, z.Shkëlqim Kajmaku, z.Ermir Petriti.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Ku është kjo? Është ajo që japim cdo vit? Kush e merr këtë cdo vit, i njëjti e merr. Dhe procedurat që ju i shtoni dhe atë e mbani në ankth, bëjini një kontratë me kushtin që po qe se ka investim publik e ka pjesë kontrate , e paralajmëron 3 muaj

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

#### **Pika 16e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES MIDIS BASHKISË KORÇË DHE SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A PËR ZGJEDHJEN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SI AGJENT TATIMOR .

**(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)**  
z.Gjergji Kristo, z.Erjon Fecanji, z.Shkëlqim Kajmaku, z.Ermir Petriti.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Gjergji ke gjë për të thënë? Pra sic ka qënë për rata që si dijnë ne i kemi pasur agjent ujësjellsit që na mbledh tarifën dhe taksat vendore për familjarët kryesisht dhe meqënëse ata kanë ndryshuar emër dhe formë organizimi.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

#### **Pika 17 e rendit të ditës**

**INFORMACION PËR NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË AKTIVEVE AFATGJATA TË NDËRMARRJES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE.**

Përfaqësuese : Duke u bazuar dhe në kriteret e udhëzimit vendosim të nxjerrim jashtë përdorimit sepse kostoja e riparimit dhe vështirësia e gjetjes së pjesës së këtyre materialeve është më e madhe.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Cilat janë këto mjete? Kjo borëpastruesja e çfarë viti është? Ne jemi ju e dini po këto do administrohen si skrap?

Përfaqësuese: Po, sipas vlerësimit do të vendoset.

#### **KËRKESA –ANKESA TË QYTETARËVE.**

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për tu diskutuar? Pa kaluar te kjo kërkesë kemi ngritur një komision, për një kërkesë që në akta ardhur për të shqyrtuar at Geri. Unë duhet të ngrej komisionin? Jut ë komisionit nuk keni mbledhur? Është muaji I tretë ky, kanë dhe afate këto nuk është se funksionojnë kështu kur kemi qejf. Ju më thoni kush është anëtarë.

Këshilltare I. Nikaj: Kush është kryetar?

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Kryetar ma thoni ju kush është, se ne ju kemi zgjedhur si anëtarë komisioni, kryetarin e zgjidhni vet. Tani çfarë tju them unë? Kush është ja ma thoni ju. Ne ju kemi zgjedhur komision të përhershëm dhe ku keni dashur jeni mbledhur dhe brenda ditës, kjo që ka tre muaj e miratuar, tani nuk e di unë kujt ti drejtohem, po me takon ta ngre si shqetësim.

Këshilltare A. Verushi: Unë thash që u diskutua herën e kaluar dhe pati një kështu përveçse vini nga jashtë, ne jemi pjesë e komisionit por nuk caktojmë individët.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Kur keni bërë njoftime që të vinë këta njerëzit dhe nuk kanë ardhur?

Këshilltare A. Verushi: Është marrë Eva dhe nuk kanë ardhur.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Po mirë të caktohet kur do e bëni këtë mbledhje? Se nuk funksionon kështu kjo punë, kur ta ketë qejf Ana, Pandi apo Irena.

Sekretare E. Naci: Ka rastisur që ose ska qëë Ana ose Irena.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Kur e keni marrë për herë të fundit në telefon profesor Nestin. Unë e di që nuk është marrë asnjëherë në telefon.

Sekretare E. Naci: E ka marrë profesor Pandi.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Edhe si ka thënë? E keni bërë njoftim për tu mbledhur?

Këshilltar P. Bello: Për tu mbledhur nuk kemi bërë njoftim. E kam lajmëruar se është zgjedhur anëtarë I komisionit.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Dhe unë e di që është në dijeni. Por kjo nuk bëhet në ajër po që se ju nuk lini një orë, nuk bëhet kështu se ju po thoni nuk po lidhemi dot.

Këshilltare A. Verushi: Nuk është çështje që nuk po lidhemi dot. Çështja është se njëri prej individëve nuk është më.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Nuk është dhe nuk ka rëndësi se janë 4.

Këshilltare A. Verushi: Në rregull nëse lejohet me 4 anëtarë po.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Edhe me tre ju lejohet. Ka mundësi që ta ndiqni pak se na vjen rëndë, e kemi detyrim ligjor.

Sekretare E. Naci: Po unë e kam ngritur me komitetit këshillimor.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Të lutem përcakto dhe një orë. Nesër në orën 11 ja e thjeshtë.

Këshilltare A. Verushi: Edhe njëherë mos ma kërko mua këtë.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Po mirë moj unë ja kërkoj këshillit. Se ka mar vendim këshilli për këtë.

Këshilltare A. Verushi: Nesër une kam angazhim tjetër.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Ka dicka tjetër nga këshilltari për të shtuar.

Këshilltare I. Nikaj: Unë kam këtë që sipas dëshirës të bëjmë atë veprimtarinë e përgjithshme, dhe propozime mund të bëjmë ose për familje ose për pensionistët e vetmuar. Sipas mundësisë të kontribuojmë për të bërë atë veprimtarinë e përditshme. Kush është dakort pa u detyruar. Eva e merr dot përsipër? Kur e ka festën bashkia?

Sekretare E. Naci: Nesër në orën 6.

Këshilltare I. Nikaj: Në Eva të kontribuojë gjithscili dhe të bëjmë pastaj aktivitetin, dhe vendosim ku të shkojmë të gjithë bashkë. Si mendoni?

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Në ckuptim si mendoj? Secili si ka ngenë. Unë jam në avion sot, sjam. Kontribut mund të të bëjë pastaj pjesa tjetër sipas mundësisë.



Këshilltare I. Nikaj: Kjo është me vullnet të lirë kush dëshiron ta bëjë.

Kryetari i këshillit E.Nexhipi: Ka ndonjë kërkesë tjetër? Pyetje?

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi



**KRYETARI**  
**ERJON NEXHIPI**



